

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
 Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
 Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7622 E enjte 16 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
 Një krim makabër e ka vënë në provë shoqërinë tonë, që prej ditësh mundohet t'i japë kuptim këtij akti ekstrem. Por, si gjithnjë, përsëritim gabimet e...
 Vijnë në faqen 20

Nga MIMOZA HYSA
Krimineli - pjellë e çmendurisë kolektive



Opinion **Ditës**
 Këtë të hënë, monedha e Turqisë, Lira turke preku nivelin më të ulët të këmbimit të saj me dollarin, duke u këmbyer me 6.97 lira një dollar. Brenda vitit 2018, ajo ka rënë...
 Vijnë në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Lira turke dhe ekonomia jonë



Dhimbje për Marjush Djerrin dhe Admir Bokrinën

Tragjedia në Xhenova, kush janë shqiptarët që mbetën në rrënoja

Pezullohen kërkimet për trupat pas shembjes së urës në Itali. 12 muaj gjendje e jashtëzakonshme

Nga PAMELA ALIAJ

Pas një dite të ngarkuar kërkimesh e punimesh janë pezulluar kërkimet për të mbijetuar të tjerë të katastrofës në Xhenova me dhjetëra të vdekur. Repubblica shkruan se kërkimet dhe operacionet e gërmimit janë ndërprerë rreth orës 13:00 pasi rrezikonte të shembej...

Në faqet 2-3

FORMULARI I APLIKIMIT PER TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE

ATP, 900 PRONARET QE MARRIN KOMPENSIMIN

Lista me përfituesit, 6 dokumentet që duhet të dorëzohen në Agjencinë e Pronave. Emrat e atyre që ndajnë fondin financiar



(Në foto) Foto ilustruese. Faksimile e formularit-tip

AFERA PER TENDERET

Inceneratorët e pandërtuar, Tabaku: Qeveria pagoi 32.8 miliardë lekë

Në faqen 5

DOKUMENTET E PLOTA

Kreditë e buta, nesër afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit

Në faqen 7

CRCA THIRRJE QEVERISE

Statistikat, mbi 750 mijë gra viktima të dhunës në familje

Në faqen 8

SUMMER PAGES

Atalanta Kërçyku: Kam ide programative që nuk janë bërë ndonjëherë në Shqipëri

Suplement

DIPLOMACIA
Negociatat me BE, MPJ thirrje për ekspertë jashtë administratës
 Në faqen 4

INTERVISTA/ Shkrimtari i njohur rrëfen jetën pas operacioneve në spital

Fatos Kongoli: Mendova Eutanazinë

Përballimi i dhimbjes me bashkëshorten dhe mjekët që "e ngritën në këmbë"

Nga BETI NJUMA

Nuk mbaj mend çfarë më preku më shumë kur hyra në dhomën e spitalit. Fakti që nuk e njoha, aq shumë që ligur e tretur, apo gjendja e pashpresë në të cilën e pashë. Atë pasdite të vonë fillim marsi, Fatos Kongoli dërgjej



në katin e parë të repartit të Kirurgjisë në QSUT, në gjendje kritike, pas dy operacioneve të vështira, që nuk dihej si do t'u shkonte filli. Qe operuar fillimisht në 12 janar, dhe ndërhyrja e dytë, më 10 shkurt kish qenë rrënuese për trupin e tij...

Në faqen 19

TRAGJEDIA NE XHENOVA BILANCI

Shkon në 39 numri i viktimave pas shembjes, mes tyre 3 të mitur

Rrezikohet shembja, pezullohen kërkimet në urën "Morandi" Xhenova

Kryeministri Conte shpall gjendjen e jashtëzakonshme 12 mujore

Pamela Aliaj

Pas një dite të ngarkuar kërkimesh e punimesh janë pezulluar kërkimet për të mbijetuar të tjerë të katastrofës në Xhenova me dhjetëra të vdekur. Repubblica shkruan se kërkimet dhe operacionet e gërmimit janë ndërprerë rreth orës 13:00 pasi rrezikonte të shembej edhe një pjesë tjetër e urës në zonën errugës "Campi". Menjëherë pas lajmërimit të rrezikut zjarrfikësit kanë nisur verifikimet për qëndrueshmërinë e urës. Dy nga tri zonat e kërkimit janë pastruar. Impakti negativ kjo urë ka dhe në izolimin e zonës me autostradën. Është kërkuar gjendja e emergjencës kombëtare dhe lutja e Papës për viktimat. Në Xhenova ekipet e shpëtimit vazhdojnë luftën me rrënojat për gjetjen e të mbijetuarve. Shpresat nuk janë shuar ende. Ndërkaq numri i viktimave ka shkuar në 39, e mes tyre 3 janë fëmijë, raporton TgCom. Sipas burimeve nga Ministria e Brendshme viktimat janë djalë 8-vjeçar dhe dy adoleshentë të moshës 12 dhe 13-vjeçare ndërsa numërohen 632 të plagosur nga aura e vdekjes. Pesë viktimat nga Amerika e Jugut janë pjesë e tragjedisë nga shembja e urës "Morandi" në Xhenova. Ata janë tre kilianë, një peruan e një kolumbian.

GJENDJA E JASHTËZAKONSHME

Në një konferencë për shtyp, kryeministri italian Giuseppe Conte tha se qeveria italiane ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme 12 mujore në Xhenova dhe shpalljen e një dite zie kombëtare në të gjithë vendin, për 39 viktimat e tragjedisë nga shembja e urës. Këshilli i Ministrave, në një mbledhje të jashtëzakonshme ka vendosur një fond prej pesë milionë euro për heqjen e rrënojave pas tragjedisë së urës "Morandi"



INCIDENTET

Veprat infrastrukturore në Itali, në 5 vitet e fundit 10 ura të shembura. Për fat të keq, tragjedia e ndodhur mesditën e së martës në Xhenova, s'është e para që trondit Italinë. Në 5 vitet e fundit, duke nisur nga viti 2013, është e gjatë lista e incidenteve, me ura të shembura e dhjetëra viktimave të numëruara.

Prokurori Cozzi: S'ishte fatalitet, por një gabim njerëzor

Shembja e urës "Morandi" në Xhenova, nisin hetimet për vrasje të fatkeqësisë së 14 gushtit

Nuk ishte fatalitet, por një gabim njerëzor", që solli rënien e urës në Xhenova. Kështu ka deklaruar kryeprokurori i Xhenovas Francesco Cozzi duke iu përgjigjur gazetareve në fund të një inspektimi në zonën e urës. Prokuroria hapi një hetim për fatkeqësi të qëllim të dhe vrasje të shumëfishta. "I përgjigjemi vetëm një pyetje: Përse ndodhi? Kjo është detyra jonë dhe për ta bërë atë do të bëjmë gjithçka që është e nevojshme. Kur të përfundojë faza e kërkimit



për viktimat dhe të zhdukurve të mundshëm, hetimi do të intensifikohet dhe do të analizohen të gjitha aspektet që lidhen me projek-

timin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e urës", shtoi Cozzi. "Hapat e parë, shpjegon ai, do të shërbejnë për të rindërtuar të gjitha punimet që po kryeshin nga pikëpamja e mirëmbajtjes dhe, gjithashtu, për të kuptuar se çfarë ndodhi atë ditë, nëse ka pasur një shkak të menjëhershëm". Në vijim, policia gjyqësore do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në institucione, kompani dhe operatorë të përfshirë në forma të ndryshme.

Giuseppe Conte. "Për pjesën më të madhe të të plagosurve, shtoi ai, sipas mjekëve ekzistojnë shpresa të mira për shpëtim". **PESE VIKTIMA TE PAIDENTIFIKUARA** Numri i viktimave nga shembja e urës "Morandi" në Xhenova është ende në rritje. Sipas asaj që u njoftua nga Ministria e Brendshme janë 5 viktimat të identifikuar, shkruan TgCom24.



Ura "Morandi" në Xhenova, pas shembjes

39

VIKTIMA

Numri i viktimave ka shkuar në 39, e mes tyre 3 janë fëmijë, raporton TgCom. Gusht zie në Xhenova, pas rënies së urës "Morandi" në autostradën A10. Bilanci ende i përkohshëm flet për të paktën 37 viktimat të konfirmuara. Midis tyre ka edhe tre të mitur: sipas burimeve nga Ministria e Brendshme, një djalë 8-vjeçar dhe dy adoleshentë të moshës 12 dhe 13-vjeçare.

'URA E FERRIT' I MERR JETËN FAMILJES

Vijojnë historitë e trishta në Xhenova pas shembjes së urës "Morandi" paraditen e së martës. Në mesin e 35 viktimave është dhe një familje italiane, e cila u shua e tëra. Roberto Robbiano, bashkëshortja e tij Ersilia Piccinino dhe djali i tyre vetëm 7 vjeç e gjysmë, Samuele u nxorën të vdekur nga rrënojat ditën e djeshme. Ata ishin nisur për drekë të gjyshi. Ishte vetëm një rrugë e shkurtër të cilën e bënin çdo ditë, por të martën ishte hera e fundit që kalonin ata urë të tmerit. Familjarët e tyre i prisnin për drekë kur lajmi në media mori dhënë. U përpoqën t'i mermin në celular, por çdo gjë ishte e kotë makina e tyre u përpi nga ura.

BILANCI

Shpërthen autocisterna, rrezohet ura në autostradën A1-A14. Bilanci: një i vdekur dhe 145 të plagosur. Rrezohet mbikalimi në autostradën A14, mes Loreto dhe Ankonas. Bilanci: shumë makina mbetën poshtë gërmadhave, 2 persona humbën jetën e dy të tjerë u plagosën. Shembet një rrugëdalje në unazën e Fasanos, provincë e Cuneos. Struktura ishte ndërtuar në vitet '90 dhe u inauguruar në 2000. S'kishte viktimat pasi askush s'po kalonte në këtë rrugë. Një urë shembet në Kalabri. S'ka persona të vdekur. Shembet mbikalimi në Annone, provincë e Leccos. Ura u rrezua për shkak të kalimit të një kamioni me 108 tonë çelik, tej kapaciteteve mbajtëse të saj. Një 68-vjeçar humbi jetën. Nga rrëshqitja e shkakuar nga moti i keq, rrezohet kolona mbajtëse në autostradën A19 Palermo-Catania. S'pati të lënduar. Rrezohet ura Scorcivacche në autostradën Palermo-Agrigento. Ishte inauguruar në 23 dhjetor të këtij viti. S'pati të lënduar. Shembet një pjesë e rrugës "Petrella", në autostradën 626 mes Ravanusas e Licatas, provincë e Agrigento. 4 persona, mes të cilëve një gura shtazë mbetën të plagosur. Në Sardegna si pasojë e përmbytjeve shembet një urë në rrugën rurale, Oliena-Dorgali. Një oficer policie humbi jetën, tre të tjerë u plagosën. Për shkak të një stuhie, shembet ura në Carasco, provincë e Ligurias, 2 persona humbën jetën.



SHKODËR - Vdekja tragjike e 32-vjeçarit Admir (Edi) Bokrina pas shembjes së urës "Morandi" në Xhenova të Italisë ka shokuar familjarët e tij. Të afërmit kanë shprehur deri në fund, ndërsa janë tronditur kur kanë mësuar lajmin e kobshëm për vdekjen e Edit. Në fshatin Oblikë të Shkodrës janë hapur dyert e mortit, ndërsa janë në pritje të mbërritjes së trupit të pajetë të të riut. Mes dhimbjes dhe lotëve, i afërmi i Admir Bokrinës ka treguar detaje nga vdekja e 32-vjeçarit. Në një lidhje telefonike për "News 24", mes tronditjes së thellë, Ruzhdi Mashku konfirmoi faktin se përveç Bokrinës, në makinë ishte edhe një tjetër shqiptar, Marjus Djerra. Po ashtu, ai bëri me dije se Edi punonte në një fabrikë dhe se një ditë para tragjedisë festoi 3-vjetorin e martesës. Gjithashtu, i afërmi i të riut u shpreh se viktimë u njoh nga një tatuazh që kishte në trup.

I afërmi: Një ditë para festoi përvjetorin e martesës

Vdekja tragjike e 32-vjeçarit Admir Bokrina, hapen dyert e mortit në Oblikë të Shkodrës



32-vjeçari Admir (Edi) Bokrina

"Një ditë para se të vdiste, Admiri ka festuar 3-vjetorin e martesës. Që prej moshës 12-vjeçare ka shkuar në Itali. Ai po shkonte në punë kur ndodhi tragjedia", tha Ruzhdi Mashku. Ndërkaq, xhaxhai i viktimës, Fatmir Bokrina tha se lajmin e hidhur e kanë mësuar në orën 01:00 të natës.

afermit janë bërë merak se nuk përgjigjej në celular. Admir Bokrina jetonte me bashkëshorten në Itali. Ishte bashkë me një shok kur ndodhi tragjedia", tha Ruzhdi Mashku. Ndërkaq, xhaxhai i viktimës, Fatmir Bokrina tha se lajmin e hidhur e kanë mësuar në orën 01:00 të natës.



TATUAZI I VIKTIMËS

Ruzhdi Marku dje bëri me dije se 32-vjeçari Admir Bokrina u identifikua nga një tatuazh që kishte në trup. 32-vjeçari jetonte në Itali që prej vitit 2000 bashkë me familjen. Në momentin e lajmit të vdekjes së tij, në Itali ka qenë vetëm i vëllai me bashkëshorten, ndërsa prindërit e 32-vjeçarit, të cilët ndodheshin në Oblikë për pushime janë nisur urgjentisht për në Xhenova të Italisë.

"Tragjedia dihej se ka ndodhur, por mbaheshim me shpresa se ishalla Edi nuk është ndodhur aty. Duke i rënë telefonit nuk m'u përgjigji dhe më pas morëm vesh se ai kishte ndërruar jetë duke shkuar në punë", u shpreh Fatmir Bokrina.

Daja i 22-vjeçarit me origjinë nga Shijaku: Fati u tregua mizor, Marjusi ishte djalë i vetëm

Tragjedia në Xhenova, mes viktimave edhe dy shqiptarë

Marjus Djerrri dhe Admir Bokrina humbën jetën teksa po shkonin në punë

Klodiana Haxhija

DURRËS

Në tragjedinë e Xhenovës që ndodhi mes ditën e së martës humbën jetën edhe dy shqiptarë. Bëhet fjalë për 22-vjeçarin Marjus Djerrri me origjinë nga Shijaku dhe 32-vjeçarin Admir Bokrina me origjinë nga Shkodra. Mësohet se në momentin e tragjedisë, dy të rinjtë po udhëtonin me furgonin e firmës italiane "Euro Pulizia", ku ishin të punësuar për shërbime pastrimi. Të martën ata ishin nisur në drejtim të Rapalos, një qytezë rreth 30 km në perëndim të Xhenovas. Furgoni i tyre ishte mes 35 autometeve që ranë nga një lartësi prej 90 metrash pas shembjes së urës "Morandi". Trupat e pajetë të dy shqiptarëve u nxorën nga gërmadhat mbrëmjen e së martës. Lajmi për vdekjen e dy të rinjve u dha fillimisht nga mediat italiane dhe më pas u konfirmua nga ambasada shqiptare në Itali. Pas lajmit të hidhur, familjarët e dy viktimave kanë hapur dyert e mortit. Në familjen Marku në Shijak, (gjyshi nga e ëma i Marjus Djerrri) presin ngushëllime për humbjen në mënyrë tragjike të 22-vjeçarit. Daja i viktimës, Fatbardh



22-vjeçari Marjus Djerrri



Daja i viktimës, Fatbardh Marku, duke folur për "GSH"

KRYEMINISTRI

Pas tragjedisë së Xhenovës ku humbën jetën 39 persona si dhe u plagosën 16 të tjerë ka reaguar kryeministri Edi Rama. Me një mesazh në italisht, Rama shkruan se tragjedia ka copëtuar zemrën e Shqipërisë. "Tragjedia e Xhenovës ka thyer zemrën e Shqipërisë. Ndjekim me frikë orë pas ore bilancin e dhimbshëm të jetëve të humbura, si dhe përpjekjet e grupeve të shpëtimt. Në mesin e rëniojave kishte edhe dy shqiptarë që banonin në Itali, por për ne ishin të gjithë vëllezër e motra".

REAGIMI I RUÇIT DHE BUSHATIT

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, i ka dërguar një letër ngushëllimi senatit dhe dhomës së deputetëve të Italisë pas tragjedisë në Xhenova. Ruçi shpreh dhimbjen e thellë për humbjen e jetëve, ndërsa u uron shërim të shpejtë të mbijetuarve. Ndërsa, ministri i Jashtëm Bushati, veç dhimbjes për humbjen e jetës së Marjus Djerrri dhe Admir Bokrina në këtë tragjedi, lajmëron se ambasada shqiptare në Itali është në gatishmëri të plotë dhe u ofron mbështetjen dhe ndihmën e shtetit shqiptar familjarëve të tyre.

Marku tha dje mes lotësh për "Gazeta Shqiptare" se Marjusi kishte vetëm 3 ditë që ishte larguar nga Shijaku, ku kishte qëndruar për rreth 2 javë për pushimet e verës. Marjusi njihej si një djalë i qeshur dhe shumë i dashur nga të gjithë të afërmit. Ndërsa para se të largohej për në

Itali, kishte puthur duart e gjyshit plot me dashuri, pasi gjyshi ishte pika e tij e dobët në Shqipëri. **DAJA I MARJUSI DJERRIT** "Marjusi ishte djalë i vetëm, kishte edhe një motër të vogël. Nëna dhe babai i Marjusi janë sipërmarrës. Ai

po shkonte në punë bashkë me shokun nga Shkodra kur ndodhi ngjarja. Fati është treguar shumë mizor: 3 ditë kishin si familje që ishin larguar nga Shijaku, pasi ishin në pushime. Para se të ikte, i puthi duart gjyshit. Ai u largua me prindërit nga Vlora drejt Italisë. Prindërit qëndruan 8 vite

pa ardhur në Shqipëri se nuk kishin dokumente. Marjusi sapo kishte mbaruar shkollën dhe punonte në biznesin e familjes", u shpreh Fatbardh Marku. Ndërkaq, mes të tjerash ai tha se nëna e Marjusi, Vali dhe babai, Gazi kishin ikur disa vite më parë drejt Italisë me gomone, në një natë të erret dimri, bashkë me dy fëmijët. Asokohe Marjusi bashkë me motrën e tij akoma dhe më të vogël u larguan drejt Xhenovës ku për familjen emigraante nga Shqipëria nisi një sfidë e vërtetë për të mbijetuar. Për plot tetë vite, nëna dhe babai i tij nuk mundën të pajiseshin dot me

dokumente, çka shtoi dashurinë e fëmijëve për të afërmit, sidomos për gjyshërit. Gjithashtu, daja i viktimës tregoi se pasi familja u pajis me dokumente, erdhi në Shqipëri, ndërsa shtoi se Marjusi nuk e kishte marruar kurrë udhëtimin me gomone nga Vlora drejt Italisë. Mes vajtjeve dhe sakrificës, prindërit kishin arritur të ngrinin një sipërmarrje, ku kishin punësuar edhe të tjerë shqiptarë. Ndërkohë, vetëm një vit më parë aty kishte nisur punë edhe Marjusi, një djalë me dëshirë e pasione, por që ëndrrat iu prenë në mes dy ditë më parë.

INTEGRIMI EKSPERTËT

MEPJ fton ekspertë nga 19 fusha të ndryshme të përfshihen në procesin e integrimit

Negociatat me BE, Ministria e Jashtme thirrje për ekspertë jashtë administratës

Komisioneri Hahn kërkoi buxhet dhe njerëz të kualifikuar

Darina Tanushi

Ministria për Europën dhe Jashtëmë fton ekspertë të ndryshme jashtë administratës shtetërore që të shprehin interesin e tyre për t'u përfshirë në këtë proces të përbashkët. MEPJ kërkoi të evidentojë burimet njerëzore jashtë administratës, me njohuritë dhe eksperiencën e nevojshme në fushat si tregti, industri, dogana dhe tatime, transport, energji, mjedis dhe zhvillim rajonal. Po ashtu, ftohen ekspertë nga fushat drejtësi, liri dhe siguri; tregu i brendshëm dhe konkurrenca; bujqësi dhe peshkim; inovacioni, shoqëria e informacionit dhe politikat sociale; çështje ekonomike dhe financiare dhe statistikat. Gjatë vizitës së tij, në Tiranë, më 17 korrik, Komisioneri evropian për Zgjerimin Johannes Hahn sugjeroi që në këtë fazë të negociatave, ku është futur Shqipëria, qysh pas vendimit të gershorit nga BE nevojitet më shumë buxhet dhe njerëz të kualifikuar. Tashmë ka nisur faza e "screening", ose ajo e përafërimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian dhe kjo është konsideruar një punë ashpër e lehtë nga kryeministri Rama. "Prej sot dhe deri në pranverën e vitit që vjen, ne jemi të detyruar ta përdorim me efikasitet maksimal kohën dhe të garantojmë një nivel të lartë koordinimi dhe ndërveprimi, jo vetëm për të thelluar reformat në fushat me rëndësi jetësore, jo vetëm për të vijuar të gjitha proceset e nisura dhe për të arritur të tjera rezultate, që nuk janë kërkesa të Brukselit, por janë detyrime ndaj vendit dhe për të ardhmen e vendit tonë, por edhe për të fuqizuar progresivisht dhe riorganizuar deri në qelizat fundore të gjitha njësitë ko-



Ministria për Europën dhe Jashtëmë

AKTET NËNLIGJORE
Bazuar në nevojën për fuqizim e strukturave koordinuese të procesit të negociatave, qeveria shqiptare ka krijuar tashmë listën prioritare të akteve ligjore e nënligjore, që do të përcillet për miratim në Këshillin e Ministrave në gjysmën e parë të shtatorit.

PRESIDENTI
Presidenti Ilir Meta ndërsa vazhdon të kalojë pushimet në bjeshkët e Prevallës në Kosovës ka postuar një foto me dy fëmijë të ardhur nga Franca për të kaluar pushimet në bjeshkë. "Sot me miqtë e mi më të rinj lirinë dhe lirinë që kanë ardhur me familjen e tyre nga Franca për të pushuar në bjeshkët e mrekullueshme të Prevallës", - shprehet Presidenti Meta.

Kreu i republikanëve: Thaçi duhet të ishte konsultuar

Ndryshimi i kufijve, Fatmir Mediu: Tirana zyrtare, heshtje vrasare

Kreu i Partisë Republikane, Fatmir Mediu iu është bashkuar reagimeve për deklaratën e presidentit Hashim Thaçi për ndryshimin e kurtit me Serbinë. I ftuar në rubrikën "Opinion" në "News24" Mediu theksoi se çështja për ndryshimin e kufijve është politikë e Beogradit, ndërsa shtoi se Thaçi është i vetëm në pozicionin e tij. "Pavarësisht nga shprehja e një vullneti politik, s'do bënin as më shumë dhe as më pak atë që vendosi faktori ndërkombëtar. Çështja e kufijve, duket se Thaçi është në pozicion të vetëm. Mendoj se Thaçi dhe përfaqësues të tjerë duhet të ulen së bashku dhe të gjykojnë se çdo bëjnë në të ardhmen. Çdo



lloj konflikti do të ishte i padomosdoshëm dhe do të krijojnë precedent të rrezikshëm. Ne duhet të rrisim rolin tonë si politikë shqiptare. Vuçiq para 3 muajsh bëri një vizitë në Rusi, ku i kërkoi Putin që të bëhet pjesë e dia-

logut me Kosovën. Pra, ka një aktivitet të Rusisë në këtë proces me Kosovën", - tha Mediu. Ndërkohë, pyetjes në lidhje me faktin nëse do të ketë një tjetër konferencë të dytë për ndryshimin e kufijve në Ballkan, ai theksoi se kjo gjë s'do t'i shërbente askujt. Ndërkohë, ai tha se Tirana zyrtare po mban qëndrim me heshtje vrasare. "Mendoj se nuk ishte që Thaçi shprehu një ide pa e diskutuar. Ajo që më shqetësoi është fakti se kur je presidenti i një shteti, duhet të konsultohesh me pozitë-opozitë. Tirana zyrtare heshtje vrasare dhe kjo është e papranueshme. Tirana zyrtare duhet të shprehë qëndrim të organizuar", - tha ai.

dinuese të procesit të negociimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian", u shpreh kryeministri Rama gjatë takimit të parë me Komisionerin Hahn, pas vendimit të BE. Për të siguruar koordinimin teknik të procesit dhe harmonizimin e të

gjithë punës përgatitore për hapjen formale të negociatave, qeveria do të ketë si koordinatort teknik zëvendësministrit për Europën dhe Punët e Jashtme. Puna e koordinatort teknik do të bazohet dhe do të varet në shkallë të madhe nga dy procese paralele;

nga njësitë ekzistuese koordinimit të procesit të integrimit evropian në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, e cila do të fuqizohet, për t'u shndërruar në Sekretariatit e ardhshëm, që do të sigurojë në kohë dhe cilësi ndërveprimin institu-



Gjatë një seance parlamentare

MISIONI NË BRUKSEL

Kryeministri Rama ka bërë të ditur se prej këtij momenti dhe deri në pranverën e ardhshme, qeveria do të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe financiare që misioni shqiptar në Bruksel të zgjerohet dhe të përfshijë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera të linjës, për të qenë gati për procesin e negociatave.



Janullatos në Vlorë, i kërkon autoriteteve vendore ndërtimin e një katedraleje

Fortlumturia e tij Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe gjithë Shqipërisë prof.dr Anastasi dhe Ignatis Trantis, Mitropoliti i Beratit, Vlorës dhe Kaninës, kanë vizituar Vlorën ku së pari janë ndalur në Institutin e prefektit të Qarkut. Klerikët e lartë janë pritur nga prefekti Flamur Mamaj dhe stafi i prefekturës. Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë Anastasi është ndalur në historinë e lashtë të Vlorës, duke e quajtur atë një thesar historik e kulturor, ndërsa ktheu në vëmendje domosdoshmërinë e ndërtimit të një katedraleje në Vlorë. "Shpresoj që brenda planeve dhe projekteve të bukura që kemi edhe pse jeni vonuar shumë, edhe tani jemi në kohë të bëjmë këtë lulen e madhe", - ka thënë Anastasi. Ndërsa e dytë e kryepeshkopi Anastas ka qenë takimi me kryetarin e Bashkisë së Vlorës, Dritan Leli. Ndërkohë mbrëmjen e së martës në Manastirin e Zvërnecit është zhvilluar një meshe për besimtarët e krishterë, ku i pranishëm ishte dhe kryepeshkopi Anastas, ndërsa bashkia ka organizuar një koncert në Manastirin e Zvërnecit.

cional dhe monitorimin e procesit. Dhe së dyti, fuqizimi i strukturave koordinuese dhe përgjegjëse në ministrinë e linjës e veçanërisht në dy ministrinë kyçe, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme, që mbajnë edhe barrën më të madhe të këtij

procesi përgatitor për kapitujt 23, 24, kapitujt që përkohë dhe me fushat prioritare të reformave të brendshme në drejtim të forcimit të shtetit të së drejtës, përbën një domosdoshmëri imediate, ka theksuar kryeministri Rama.



JORIDA TABAKU
"Qeveria që në aktin normative ka ulur shpenzimet për mirëmbajtjen e mbetjeve, vazhdon të paguajë nga buxheti i shtetit duke kryer jo vetëm një krim ekonomik që nis me abuzimin e 32.8 mld lekëve, por edhe një krim ambientalist dhe social, pasi do të mbushë tre qytetet të vendit me plehurat që do të importohen nga jashtë", - tha zj.Tabaku



ERION BRAÇE
"A ka probleme me prokurimin publik në këtë vend? Po! Problemi mbetet tek vërtetësia e garës, të qënit e hapur, e lirë, përfshirëse, e vërtetë! Demokratizimi i punëve publike, pa humbur asgjë në cilësi dhe çmim nis nga këtu!", shprehet deputeti i PS-së, Erion Braçe.

Afera, PD publikon dokumentin: Lidhja e shkurtër me pronarin real të inceneratorëve

Inceneratorët e pandërtuar, Tabaku: Qeveria pagoi 32.8 miliardë lekë "2.2 mld lekë mikut të ministrit Ahmetaj"

PD premtonte rishikimin e çdo koncesioni abuziv

'Check up', Spahia: Rama i falë Vilma Nushit 7 milionë euro për analiza të pakryera

Demokratët paralajmërojnë anulimin e koncesionit të 'check up'-it, për të cilin shprehet se është një nga aferat më korruptive dhe klienteliste të qeverisë "Rama". Nisur nga shkeljet e evidentuara në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, opozita pretendon se qeveria ka çuar në arkën e koncesionarit 7 milionë euro për 145 mijë vizita fiktive. "Pavarësisht se analizat e 'check up'-it i ka kryer vetëm 26 % e popullsisë, kompania e Vilma Nushit, kliente dhe sponsore e Edi Ramës, është paguar me 22 milionë euro, 7 milionë prej të cilave për analiza të pakryera kur-re", deklaroi deputeti i PD-së. Opozita denoncoi përmes Bardh Spahiut se abuzimi shkon edhe më tej, pasi sipas saj edhe Drejtoria e Tatimeve është vënë në shërbim të koncesionarit. "Ka rimbursuar 1.8 milionë euro TVSH për koncesionarin e 'check up'-it, pavarësisht se ligji i përjashton shërbimet shëndetësore nga detyrimet tatimore", theksoi z.Spahia. Pavarësisht rekomandimit të KLSH-së për rishikimin e kontratës nga e cila duhet të eliminohet pagesa për shërbimet e pakryera, opozita shprehet se hesht jo vetëm kryeministri, por edhe organi i akuzës që sipas saj duhet të hetonte zyrarët e lartë për abuzim me fondet publike në favor të një kompanie private. Spahia tha se Rama, Beqja, Manastirliu ndajnë miliona euro me klientët, ndërsa mjekët dhe infermierët ikin nga vendi. Deputeti demokrat u shpreh se PD do të anulojë koncesionin e dështuar të 'check up'-it dhe çdo koncesion tjetër korruptiv në kurritz të parave të shqiptarëve.



AKUZA

Spahia tha se Rama, Beqja, Manastirliu ndajnë miliona euro me klientët, ndërsa mjekët dhe infermierët ikin nga vendi. Deputeti demokrat u shpreh se PD do të anulojë koncesionin e dështuar të 'check up'-it dhe çdo koncesion tjetër korruptiv në kurritz të parave të shqiptarëve.

Në përfundim, deputeti demokrat u shpreh se Partia Demokratike do të anulojë koncesionin e dështuar të 'check up'-it dhe çdo koncesion tjetër korruptiv në kurritz të parave të shqiptarëve.

Valentina Madani

Deputetja e PD, Jorida Tabaku publikoi dje dokumentin e shpronësimit publik që i hap rrugë inceneratorit të Tiranës. Përmes një postimi në "Facebook", Tabaku akuzoi se qeveria ka paguar 32.8 mld lekë për inceneratorët që nuk kanë nisur të ndërtohen. Deputetja e PD shprehet se taksat e shqiptarëve shkojnë në xhepin e Klodian Zotos për ndërtimet e inceneratorëve të plehrave. "Qeveria ka paguar 32.8 mld lekë për inceneratorët që nuk kanë nisur të ndërtohen! Ujku fle, hasmi i shqiptarëve jo! Në mesin e vapës së gushtit qeveria dhe Bashkia Tiranë janë përkujdesur që të nisin procedurat e shpronësimit për inceneratorin e plehrave që do të ndërtohet në Tiranë. Këto procedura rikonfirmojnë edhe një herë se deri më sot qeveria i ka paguar 2.2 mld lekë mikut të ministrit Ahmetaj për punime të panisura. Sipas Vendimit të Qeverisë, firmosur në gusht 2018, është vendosur shpronësimi i tokës për nisjen e ndërtimit të inceneratorit me një vlerë prej 322 milionë lekësh", deklaroi zj.Tabaku. Në emër të Partisë Demokratike, Tabaku përmendi se ka thirrur në interpelancë ministrin Gjikuari për aferën 178 mln euro të inceneratorëve. Sipas Tabakut, në interpelancë u zbulua procedura antikushtetuese dhe antiligjore, u dëshmuua mungesa e garës dhe kompanie fantazmë e 'offshore' që krijohen një javë përpara se të jepet koncesioni. "Por - tha ajo - mbi të gjitha u zbulua lidhja e shkurtër me pronarin real të inceneratorëve. Deputetja e PD-së akuzoi se qeveria heshti edhe kur ajo u referë u përmendte në Raportin e Progresit të BE si një çështje shumë e debatueshme ambientale dhe që bie në kundërshtim me normat e BE dhe jo vetëm. "Ndonëse me kaq shumë deficite, qeveria është përkujdesur që paguajë nga buxheti i shtetit për këtë koncesion 32.8 mld lekë (12 mld Fieri; 18.6 mld Elbasani; 2.2 mld Tiranë) të vetmes kompani që ka fituar inceneratorët në të tria qytetet, ndonëse asnjë tullë nuk është hedhur



Deputetja e PD, Jorida Tabaku

PROCEDURAT

"Qeveria ka paguar 32.8 mld lekë për inceneratorët që nuk kanë nisur të ndërtohen! Ujku fle, hasmi i shqiptarëve jo! Në mesin e vapës së gushtit qeveria dhe Bashkia Tiranë janë përkujdesur që të nisin procedurat e shpronësimit për inceneratorin e plehrave që do të ndërtohet në Tiranë.

për to", u shpreh Jorida Tabaku. Ajo akuzoi se taksat e shqiptarëve shkojnë në xhepin e Klodian Zotos për ndërtimet e inceneratorëve të plehrave, ndërsa ato vazhdojnë të mbeten në padije të plotë për kushtet e kontratave. "Qeveria që në aktin normative ka ulur shpenzimet për mirëmbajtjen e mbetjeve vazhdon të paguajë nga buxheti i shtetit duke kryer jo vetëm një krim ekonomik që nis me abuzimin e 32.8 mld lekëve, por edhe një krim ambientalist dhe social, pasi do të mbushë tri qytete të vendit me plehurat që do të importohen nga jashtë. Një hasëm të tillë shqiptarët nuk e kanë gjetur as tek pushtetist e tyre", - u shpreh deputetja e PD-së, Jorida Tabaku.

Përbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të Dytë për pasuritë e paluajtshme si më poshtë;

- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 5 284 440 Lekë.
- Pasuria Nr. 250/3+1-3, Vol.-31, fq.-235, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 5 284 440 Lekë.
- Pasuria Nr.211/11, Vol.-4, fq.-201, Z.k-1791, Illoji Tokë-0Ari e Sip.- 500 m2, ndodhur në Golem Kavajë, me vlerë 280 000 Lekë.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 23.08.2018, në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kall -2, Tiranë. Cel. 069 73 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com

SHPALLJE ANKANDI
Datë 23.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përbarimtare "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e dytë për pasuritë e paluajtshme të debitorit Enkelea Novaku dhe dorëzuesit Adriatik Novaku:

"Trulli" me sipërfaqe 100 m² dhe "Ndërtesa" me 3 kato me sipërfaqe 90 m² secili, nr.1 pasurisë 4/106, zona kadastrale 85/1, vol. 13, faqe 69, adresa: Lajla Nr. 1, Pogradec.

Çmimi fillues i ankandit të dytë është në shumën 7 280 000 (shtatë milionë e dytind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Ankandit do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimtare "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Nënkryetari i grupit parlamentar sqaron projektin për dekomunistizimin

Nisma e PD-së, Alibeaj: Shënim në libra e filma për artin në diktaturë

P prej vjeshtës së vitit të kaluar Partia Demokratike po punon për një kuadër të ri ligjor për dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare. Një draft i është cuar për mendim fondacionit gjerman "Conrad Aduener", i cili pasi ka dhënë një mendim nga pikëpamja historike, pritet të vlerësojë edhe anën juridike të projektit. Nënkryetari i grupit parlamentar të PD-së, Enkelejd Alibeaj tha për "Vision Plus": "Problemi kryesor është që ky ligj të mundësojë krijimin e një lëvizjeje psikopublike për të ndëshkuar propagandën komuniste dhe përdorimin e simboleve". Në lidhje me propagandën, Partia Demokratike synon të rregullojë me ligj edhe çështjet që kanë të bëjnë me artin e realizimit social-

DRAFTI

E ndërsa PD pret ekspertizën e fondacionit gjerman "Conrad Aduener", drafti do të mbetet në zyrat e Kuvendit, nëse opozita nuk siguron konsensusin dhe votat e shumicës për të miraturat këtë iniciativë.

ist. "Biem dakord që arti në një dozë të madhe në atë kohë; libra, filma apo edhe mjete të tjera të propagandës të kamufluara me elementë artistikë ishin një nga elementet kryesore, të cilat ndikuan në deformimin e formimit artistik apo edhe politik të shoqërisë

komuniste në atë kohë. Madje, unë besoj që është një nga mjetet më të rrezikshme, të cilat deformuan dhe deformojnë edhe sot mënyrën se si do të duhet njerëzit të jenë të qartë për të drejtat e tyre, për lirinë", tha ai. Ajo që kërkohet të bëjë Partia Demokratike

është vendosja e një shënimi tek çdo film apo libër për të shpjeguar diktaturën komuniste, pa përjashtuar asnjë film apo libër, përfshi edhe ata të një prej figurave më të rëndësishme të letërsisë sonë si Ismail Kadare. "Mjetet që do të duhet të përdorim siç është shoqëria e civilizuar sot, të mos e privojë individin për të marrë informacionin të cilin do, të cilin pëlqen, por duke i dhënë paralelisht në njëjtën kohë informacionin tjetër atë real, atë të vërtetë, që në fund të fundit për çdo libër, qoftë edhe të Kadare, kur ta lexojë të mos dalë i



mpirë në arsyetimin e vet për situatën apo për gjendjen që ka qenë, por të shohë edhe faqet e tjera të librit të pashkruar të Kadare, ato të cilat diktatura nuk ia lejonte të shkruante", u shpreh Alibeaj. Edhe pse është i vetëdijshëm për debatit që hap një nisëm e tillë, Alibeaj beson se kjo është një zgjidhje e drejtë për shoqërinë. Sipas Alibeajt, "këto faqe të zeza të pashkruara sepse censuroheshin në atë kohë do të duhet t'ia japim si informacion sot, në mënyrë që edhe libri i Kadare të lexohet i plotë dhe të kuptohet jo thjesht Kadareja, por të kuptohet sistemi komunist i asaj

kohë".

Zv.kryetarja e Kuvendit pret përfaqësuesin e Asamblesë së OSBE-së

Hysi: Kuvendi, kontribut në proceset e integrimit

Berisha me OSBE: Rama po përdor reformën për të kapur drejtësinë

Zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Vasilika Hysi priti dhe përfaqësuesin e Posaçëm të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së për Evropën Juglindore, Mark Pritchard dhe ambasadorin Andreas Nothelle nga Asambleja Parlamentare e OSBE në Vjenë. Gjatë takimit u bisedua për kontributin e Kuvendit të Shqipërisë në proceset e integrimit evropian, ecurinë e punës së Komisionit parlamentar për Reformën Zgjedhore, trajtimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, reformën në drejtësi si edhe ecurinë e procesit të vetingut. Bashkëbiseduesit nënvizuan se realizimi i këtyre reformave kërkon angazhimin jo vetëm të maxhorancës, por edhe të opozitës. Nënkryetarja e Kuvendit, Hysi vuri theksin në forcimin e rolit të Kuvendit të Shqipërisë në hartimin e ligjeve dhe kontrollin parlamentar, përfshirjen më të madhe të Kuvendit mes komisioneve dhe nënkomisioneve parlamentare dhe grupimet e tjera parlamentare si grupi i deputetëve "Miqte e fëmijëve" dhe grupimi i grave deputete. Znj. Hysi ftoi përfaqësues të Asamblesë parlamentare të OSBE-së për të marrë pjesë në konferencën që do të organizojë Kuvendi për rolin e parlamentare për parandalimin e trafikimit dhe formave të tjera të skllavërisë moderne. Vizita e z. Mark Pritchard është vizita e parë e tij pas zgjedhjes këtë vit si përfaqësues i Posaçëm të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Përfaqësuesit e lartë të OSBE-së shoqërohen nga zëvendësambasadori i Prezencës së OSBE në Tiranë, Robert Wilton.



Zv.kryetarja e Kuvendit Vasilika Hysi, dje me përfaqësuesin e Posaçëm të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së për Evropën Juglindore, Mark Pritchard dhe ambasadorin Andreas Nothelle nga Asambleja Parlamentare e OSBE në Vjenë

cionin se i njohu bashkëbiseduesit me kolapsin e plotë të qëllimshëm të sistemit të drejtësisë. "Duke përdorur reformën për të shndërruar drejtësinë, sipas projektit orwellian të George Soros, degë të ekzekutivit të Edi Ramës, u asgjësuan Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë dhe së shpejti do të eliminohet edhe Gjykata e Apelit. Të gjitha funksionet e gjykatave të paralizuar i ka sot Edi Rama, i cili me kontrollin total të drejtësisë, ka bërë që 97% e të gjitha proceseve gjyqësore fitohen nga qeveria. Ata të cilët bëjnë të mundur këtë falimentim total të drejtësisë nëpërmjet vetingut, fajësojnë për këtë korrupsionin e gjyqtarëve", u shpreh Berisha, në lidhje

me ato çka u biseduan në takim. "Në ekspozitë time theksova se jo vetëm vetingu po bën gjuhën e shtrigave, por edhe Shkolla e Magjistraturës, e shndërruar plotësisht në shkollë partie, po përgatit drejtësinë partiake. Drejtues të kësaj shkolle u japin leksione në sallat e gjykatave të rinjve ekstremistë të majtë, anëtar të fondacionit të PS 'Qemal Stafa' dhe ata përbëjnë listën e atyre që do të rekrutohen për të vazhduar Shkollën e Magjistraturës", u shpreh më tej Berisha. Me delegacionin e OSBE-së u takua edhe kryetari i Partisë Republikane, Fatmir Mediu. Gjatë një takimi në Tiranë me deputetin britanik Mark Pritchard, Mediu tha se mosfunksioni

mi i Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë po krijojnë një situatë të paprecedentë për Shqipërinë. Mediu u ndal po ashtu edhe tek rëndësia e Reformës Zgjedhore. Sipas tij, kjo reformë pa një gjyqësor të pavarur nuk do të jetë efikase, sepse çdo rezultat final do të vendoset nga gjykata nën kontrollin e qeverisë. Mediu dhe i dërguari i Asamblesë Parlamentare të OSBE ndan të njëjtin mendim se situata gjeopolitike në Ballkan është shumë shqetësuese. Sipas tyre, ka forca të interesuara për të shmangur Ballkanin nga rruga evropiane dhe NATO, me synim rizgjim të konflikteve të vjetra gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

REFORMAT

Realizimi i reformave kërkon angazhimin jo vetëm të maxhorancës, por edhe të opozitës. Nënkryetarja e Kuvendit, Hysi vuri theksin në forcimin e rolit të Kuvendit të Shqipërisë në hartimin e ligjeve dhe kontrollin parlamentar, përfshirjen më të madhe të Kuvendit mes komisioneve dhe nënkomisioneve parlamentare.

Kreu i grupit të LSI i kërkon ndihmë OSBE për reformën zgjedhore


Vasili: Shitblerja e votës, kërcënuese për demokracinë

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili zhvilloi dje një takim me Mark Pritchard, përfaqësues i posaçëm i OSBE për Evropën Juglindore dhe ambasadorin Andreas Nothelle, nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së. Në fokus të këtij takimi, Vasili diskutoi me Pritchard për zhvillimet aktuale politike në Shqipëri, ndërsa u ndal gjerësisht tek Reforma Zgjedhore. Vasili tha se LSI dhe kryetaria e saj, Monika Kryemadhi vazhdimisht kanë shprehur mbështetjen për Reformën Zgjedhore. "Po i afrohem muajit shtator dhe në qershorin që vjen kemi zgjedhje. Të bësh ndryshime në sistemin zgjedhor e të realizosh zgjedhje sipas atyre ndryshimeve duhet kohë, sepse duhet të trajnohen mirë e siç duhet njerëzit, që është diçka që s'realizohet dot për zgjedhjet lokale. Shpresoj që përmes vizitës suaj të shtyni që këto gjëra të bëhen me ritme sa më të shpejta", tha kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili. Po ashtu, ai u ndal edhe tek fenomeni i shitblerjes së votave, që sipas tij është prezent në vendin tonë. "Problemi kryesor është shitblerja e votave. Duhet zgjidhur problemi i shitblerjes së votës, sepse përmes tyre del një pushtet i korruptuar, media e kapur, siç e kemi tani dhe problemi nuk është më thjesht i partive politike, por shitblerja e votës është një problem kërcënues për demokracinë. OSBE duhet t'i adresojë gjërat në mënyrë më të drejtëpërdrejtë. Ne kemi që në 2016-ën që kemi bërë propozimet tona në tavolinën e komisionit se si mund të luftohen këto gjëra, por nuk janë marrë parasysh. Roli i LSI në të ardhmen do të jetë që të shtyjë për realizimin sa më parë të Reformës Zgjedhore dhe implementimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR për zgjedhjet", tha Vasili.



KREDITË E BUTA DOKUMENTACIONI

Lista me dokumentet e plota që duhet të paraqesin fituesit e fazës së parë



Voltiza Duro

Nesër është afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit për të gjithë ata që janë shpallur fitues në fazën e parë të aplikimit për kreditë e buta në kryeqytet. Sipas vendimit të Bashkisë së Tiranës, mbi fazën e dytë të programit social "Subvencionimi i interesave të kredisë", zbardhur pak kohë më parë nga "Gazeta Shqiptare", 17 gushti i këtij viti është afati i fundit i pranimit të dokumenteve. "Fituesit e fazës së parë duhet të dorëzojnë dokumentet nga data 16.07.2018 deri më 17.08.2018 pranë Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët në Bashkinë Tiranë", - thuhet në njoftim. Aplikuesit duhet të tregojnë shumë kujdes, pasi nëse nuk dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar, humbasin mundësinë për të fituar shtëpinë me kredi të butë. Bashkia e Tiranës thekson se nuk do të ketë një fazë tjetër për dorëzimin apo pranimin e dokumentacionit.

KATEGORITË PËRFITUESE

Ky program u vjen në ndihmë të gjitha cifteve të reja, të cilat kanë një nivel të caktuar të ardhurash nga punësimi dhe dëshirojnë të blejnë një shtëpi, por e kanë të pamundur të përfitojnë një kredi me kushtet e tregut. Kështu, Bashkia e Tiranës u subvencionon interesat e kredisë. Për të përfituar nga programi i "Subvencionimit të Interesave të Kredisë", aplikuesit duhet të plotësojnë disa kritere, ku më kryesoret janë: familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar, individët të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjeç, familjet të cilat në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë, si dhe familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit.

DOKUMENTACIONI

Këtë vit janë plot 500 qytetarë që do të shpallen fitues e do të përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë". Personat që kaluan fazën e parë duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashkinë e Tiranës dokumentacionin e nevojshëm që vërteton deklarimin dhe vërtetësinë e

Kreditë e buta, nesër afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit

Bashkia e Tiranës: Kujdes, nuk ka fazë tjetër pranimi!



17

GUSHT, AFATI I FUNDIT

"Fituesit e fazës së parë duhet të dorëzojnë dokumentet nga data 16.07.2018 deri më 17.08.2018 pranë Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët në Bashkinë Tiranë", - thuhet në njoftim. Aplikuesit duhet të tregojnë shumë kujdes, pasi nëse nuk dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar, humbasin mundësinë për të fituar shtëpinë me kredi të butë.

500

KREDI TË BUTA

Këtë vit janë plot 500 qytetarë që do të shpallen fitues e do të përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë". Personat që kaluan fazën e parë duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashkinë e Tiranës dokumentacionin e nevojshëm, që vërteton deklarimin dhe vërtetësinë e plotësimin të formularit të strehimit në bazë të të cilit janë përzgjedhur fitues.

plotësimin të formularit të strehimit, në bazë të të cilit janë përzgjedhur fitues. Respektivisht kandidatët duhet të dorëzojnë: formularin e strehimit, certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare, vërtetim të vendbanimit në bashkinë ku kërkohet vendstrehimi, vërtetim të të ardhurave neto të familjes apo individit, vërtetimin e punësimit si dhe dokumen-

tin për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë anëtarët e punësuar në familje. Gjithashtu, aplikantët duhet të paraqesin pranë zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashkinë e Tiranës edhe vërtetimin nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes, vërtetim nga zyra e punës për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë, vërtetim nga orga-

net e sigurimeve shoqërore për personat në pension, dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, vërtetim nga ZRPP se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis që mund të përdoret si e tillë, vërtetim nga ZRPP për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, vërtetim nga ZRPP të origjinës se nuk figuron e regjistru-

ar asnjë pronë, vendimin e gjykatës, që ilë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara. Ndërkohe, qytetarët duhet të dorëzojnë edhe një vërtetim për librezën e jetimit për individët me këtë status, vërtetim nga komisioni mjekësor për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara; dokument për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe

azilkërkues; dokument për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Policisë së Burgjeve etj.; dokument për viktimat e dhunës në familje si dhe një deklaratë materiale që lëshohet nga kryefamiljari, që shprehet se është dakord që kredia të lëvrohet për aplikantin që rezulton i përfshirë në Formularin e Strehimit.

DOKUMENTACIONI QË DUHET DORËZUAR:

1. Formulari i Strehimit i plotësuar pranë njësies administrative në të cilën aplikanti ka vendbanimin.
2. Certifikata e lindjes e aplikantit dhe certifikata e gjendjes familjare.
3. Vërtetimi i vendbanimit në bashkinë ku kërkohet vendstrehimi, ose leje banimi për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.
4. Vërtetimi i të ardhurave neto të familjes/individit.
5. Dokumenti përkatës nga punëdhënësi (vërtetim punësimi), për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit dhe të personave të tjerë të familjes që janë në marrëdhënie pune.
6. Dokumenti nga organet tatimore dhe nga sigurimet shoqërore për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë anëtarët e punësuar në familje.
7. Vërtetimi nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të qeverisjes vendore për anëtarë, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuara.
8. Vërtetimi nga zyra e punës e njësies vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë.
9. Vërtetimi nga organet e sigurimeve shoqërore për pension.
10. Dokumenti zyrtar i celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja.
11. Vërtetimi nga ZRPP se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis që mund të përdoret si e tillë.
12. Vërtetimi nga ZRPP për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi për strehim.
13. Vërtetimi nga ZRPP të origjinës se

14. Vendimi i gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara, shoqëruar me vërtetimin nga zyra e përbarimit për masën e pensionit që përfitojnë për fëmijët.
15. Vërtetimi përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit.
16. Vërtetimi nga komisioni mjekësor për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara.
17. Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe azilkërkues.
18. Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Policisë së Burgjeve etj.
19. Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje. Urdhri i mbrojtjes i lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar (fotokopje e njehsur me origjinalin). Vërtetim nga strukturat e shërbimit social, qendrave sociale dhe rehabilitimit për viktimat e dhunës pranë njësive të qeverisjes vendore.
20. Deklaratë materiale që lëshohet nga kryefamiljari, që shprehet se është dakord që kredia të lëvrohet për aplikantin që rezulton i përfshirë në Formularin e Strehimit.

DHUNA NË FAMILJE RAPORTI

750

MIJË GRA TË DHUARA

Vajzat dhe gratë përbëjnë thujtë gjysmën e popullsisë me rreth 1,431,714 persona (INSTAT). Në Shqipëri dhuna në familje vazhdon të jetë e përhapur në të gjitha shtresat e shoqërisë. Sipas INSTAT dhe UNDP mbi 53 % e tyre, ose rreth 750 mijë gra dhe vajza në Shqipëri, deklarojnë se kanë qenë të paktën një herë në jetën e tyre viktime të dhunës në familje. Numri i fëmijëve dhe adoleshentëve nën moshën 19 vjeç arrin në rreth 721,586 persona (INSTAT).

14%

E POPULLSISË VARFËRI ABSOLUTE

Shqipëria vijon ende të mbetet një ndër vendet më të varfëra në Europë. Sipas Bankës Botërore, thuhet se 14 % e popullsisë vijon të jetojë në varfëri absolute, ndërsa thuhet se 47 % e popullsisë jeton në varfëri relative, krahasuar me 22 % që është në vendet e rajonit. Deri në fund të vitit 2017, sipas INSTAT, në Shqipëri përfitonin ndihmë ekonomike të plotë ose të pjesshme mbi 327,735 persona ose 11.4% e popullsisë në vend.

28%

TË RINJ TË PAPANË

Në raportin më të fundit të Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri, të rinjtë në Shqipëri gjenden përballë faktit se 26 % e tyre janë të papunë, duke e renditur vendin tonë ndër të parët në Europë për këtë problematikë (ILO 2015). Indeksi Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri evidencoi se 81 % e organizatave rinore nuk gjejnë asnjë mbështetje për punësimin rinor nga qeveria. Rreth 70 % e të rinjve dëshirojnë të emigrojnë nga Shqipëria dhe rreth 80 % e tyre nuk marrin asnjë shërbim miqësor rinor.



Shtëpia e djegur nga 42-vjeçarja Rudina Kishta

CRCA thirrje qeverisë: Shqipërisë i duhet urgjentisht një ministri për familjen

Voltiza Duro

Sipas të dhënave më të fundit nga Instituti i Statistikave, mbi 750 mijë gra dhe vajza janë viktime të dhunës në familje; ndërsa mbi 360 mijë fëmijë dhe adoleshentë janë viktime të dhunës dhe shfrytëzimit. Ndërkohë statistikave tregojnë se mbi 100 mijë fëmijë jetojnë në varfëri; 182 mijë të rinj e të reja janë të papunë; mbi 327,735 persona në Shqipëri marrin ndihmë ekonomike; ndërsa mbi 46% e të dënuarve për krime janë fëmijë dhe të rinj. Këto të dhëna alarmante kanë nxjerrë reagimin e fortë të shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të cilat kanë kërkuar krijimin e ministrisë së familjes. Ditën e djeshme, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), me anë të një thirrjeje të hapur i ka propozuar qeverisë dhe Kuvendit të Shqipërisë se është bërë urgjente nevojja për hapjen e ministrisë për familjen, si një institucion përgjegjës për mbrojtjen dhe fuqizimin e familjes, në mënyrë të veçantë të grave, fëmijëve dhe të rinjve, si dhe zbatimit të një plani të ri kombëtar masash për fuqizimin e familjes në Shqipëri. "Pavarësisht se Shqipëria ka bërë përmirësime të ndjeshme të kuadrin legjislativ dhe të politikave për grupet më të rrezikuara të shoqërisë, përsëri të dhënat tregojnë se familja është nën goditjen e vazhdueshme të

Statistikat, mbi 750 mijë gra viktime të dhunës në familje

Altin Hazizaj: Familja shqiptare në rrezik



Altin Hazizaj, drejtor i CRCA

një sërë faktorëve shoqërorë, që rrezikojnë seriozisht mirëqenien e saj. Kushtetuta e detyron Kuvendin, qeverinë, bashkitë dhe sistemin e drejtësisë që të kujdesen për familjen, duke dhënë ndihmë, mbështetje dhe mbrojtje për çdo anëtar të saj, sidomos për gratë, fëmijë dhe të rinjtë", thotë për

"Gazeta Shqiptare" Altin Hazizaj, drejtor i përgjithshëm i CRCA Albania. Ky i fundit më tej bën me dije se në thirrjen drejtuar parlamentit dhe qeverisë, propozohet hapja urgjentisht e një Programi Kombëtar për mbështetjen e familjes, gruas, fëmijëve dhe të rinjve në vend, për krijimin e

shërbimeve komunitare për familjen në çdo Bashki të Shqipërisë. "Kuvendi i Shqipërisë, në hapjen e legjislaturës së re në shtator 2018, duhet të shohë me prioritet bërjen e përmirësimeve ligjore të menjëhershme për të bërë të mundur pagesën e plotë të lejes së lindjes për të paktën 1 vit për nënat dhe baballarët, të kombinuar me krijimin e pagesës për fëmijë për çdo familje të paktën deri në moshën 10 vjeç!

për nënat dhe baballarët, të kombinuar me krijimin e pagesës për fëmijë për çdo familje të paktën deri në moshën 10 vjeç! Ndërsa Shqipëria ende nuk e ka një institucion të tillë, mbi 30 shtete prej vitesh tashmë e kanë krijuar një ministri të tillë", shton Hazizaj për "GSH".

Mbi 46% e të dënuarve në burgje janë të rinj

Sipas të dhënave të publikuara ditën e djeshme nga CRCA, rreth 100,000 fëmijë jetojnë në varfëri ndërsa mbi 50 mijë fëmijë të moshës 6-15 vjeç janë të detyruar të punojnë në punë familjare dhe në rrugë për të siguruar mbijetesën e tyre. Mbi 60% e fëmijëve në Shqipëri sipas studimit BECAN kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës, përfshirë këtu dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe neglizhencë. "Rreth 11% e fëmijëve deklarojnë se janë viktime të dhunës dhe ngacimeve seksuale nga një i rritur. Gjendja e të rinjve paraqitet po aq shqetësuese. Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç përbëjnë rreth 25% të popullsisë, me rreth 695,836 persona (INSTAT)", thotë Hazizaj për "GSH". Ndërkohë mbi 46% e të dënuarve në burgje në Shqipëri janë të rinj dhe të reja. Sakaq Shqipëria gjendet në një situatë kritike për sa i përket turrës dhe plakjes së popullsisë. Sipas të dhënave zyrtare në këto 27 vjet, lindjet kanë pësuar rënie drastike. Në vitin 2017 kishte vetëm 30.8 mijë lindje, niveli ky më i ulët i regjistruar ndonjëherë, më një rënie prej 62% të lindjeve krahasuar me vitin 1990.

KËRKESAT E CRCA

Nisur nga të gjitha këto fakte dhe të dhëna, ne sot i kërkojmë Kuvendit dhe qeverisë shqiptare sa më poshtë:

1. Krijimin e Ministrisë për Familjen, si një institucion përgjegjës për kujdesin, mbrojtjen dhe fuqizimin e familjes në Shqipëri dhe të gjithë anëtarëve të saj.
2. Hapjen urgjentisht të një Programi Kombëtar për mbështetjen e familjes, gruas, fëmijëve dhe të rinjve në vend, për krijimin e shërbimeve komunitare për familjen në çdo Bashki të Shqipërisë;
3. Kuvendi i Shqipërisë, në hapjen e legjislaturës së re në shtator 2018, duhet të shohë me prioritet bërjen e përmirësimeve ligjore të menjëhershme për të bërë të mundur pagesën e plotë të lejes së lindjes për të paktën 1 vit për nënat dhe baballarët, të kombinuar me krijimin e pagesës për fëmijë për çdo familje të paktën deri në moshën 10 vjeç!

Vendimi, gjykata e Fierit jep masën e sigurisë "Arrest me burg"

Trondit në sallën e gjyqit 42-vjeçarja: 2 vajzat do t'i mbysja se janë të miat

Rudina Kishta: Unë e dogja shtëpinë e bashkëjetuesit, më rrihte prej 6 muajsh

FIER

Unë ia kam vënë flakën shtëpisë, sepse bashkëjetuesi im, Ardian Gjika prej 6 muajsh më rrihte mua dhe dy vajzat e mia". Kështu ka deklaruar dje në sallën e gjyqit, 42-vjeçarja Rudina Kishta, e cila u arrestua pasi dy ditë më parë dogji shtëpinë e bashkëjetuesit të saj në fshatin Greçall të Fierit dhe më pas tentoi të mbysë në lumin Seman dy vajzat e saj binjake. Pas prezantimit të palëve në proces dhe dëshmisë së dhënë nga e pandehura, trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtari Taulant Banushi vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Kishtës. Gruaja akuzohet për veprat penale: "Vrasja për shkak të rrethanave familjare" e mbetur në tentativë dhe "Shkatërimi i pronës me zjarr".

DËSHMIA E 42-VJEÇARES

Rudina Kishta dje ka shokuar me deklaratën e saj dhënë gjatë seancës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Fierit. Ajo iu është shprehur para gazetarëve se prej 6 muajsh jetonte në kushte të vështira. "Kam 6 muaj që jetoj në kushte të vështira dhe bashkëjetuesi ishte i dhunshëm dhe pinte", ka thënë 42-vjeçarja nga kafazi i hekurit. Po ashtu Kishta ka pranuar edhe tentativën për mbytjen e dy vajzave të saj të mitura. "Vajzat do i mbysja në lum, pasi janë të miat dhe të askujt tjetër", është shprehur Kishta.

ARRESTIMI

Gruaja u vu në pranga, pasi dyshohet se ka tentuar të vrasë dy vajzat e saj binjake 6 vjeçe duke tentuar t'i mbyste ato në ujërat e lumit Seman në afërsi të urës së fshatit Daullas në Pier. Mësohet se dy të miturat kanë mundur të shpëtojnë falë ndërhyrjes se peshkatarëve. Njëri prej tyre ka deklaruar në polici se kishte parë një grua që u zhyste kokën në ujë vajzave të vogla. Ndërkohë, banorët janë shprehur se janë shokuar nga kjo ngjarje. Pas arrestimit për zjarrvënien, 42-vjeçarja ka mohuar djegien e shtëpisë së bashkëjetuesit të saj, Ardian Gjika. Por, pas rimarrjes në pyetje, ajo ka pranuar autorësinë e



Rudina Kishta në sallën e gjyqit

AKUZAT

Burime zyrtare nga policia e Fierit bënë me dije se 42-vjeçarja Rudina Kishta akuzohet për veprat penale: "Vrasja për shkak të rrethanave familjare" e mbetur në tentativë dhe "Shkatërimi i pronës me zjarr". Mësohet se pas arrestimit, dy vajzat e saj janë marrë në mbrojtje dhe janë transferuar në një institucion kujdesi në kryeqytet.

Ardian Gjika: Më thanë shokët se po të digjet shtëpia, mendova se po bënin shaka

FIER - Dy ditë më parë Ardian Gjika tregoi për "Gazeta Shqiptare" se si e mori vesh ngjarjen, ndërsa mendonte se shokët po bënin shaka kur i thanë se po i digjej shtëpia. 47-vjeçari tha se gruan, me të cilën nuk kishte bërë celebrim e kishte marrë dy net më parë pas një ndarjeje disa muajore. Sipas tij kishte qenë vetë gruaja që i kishte thënë që do kthehej në shtëpi. **Zoti Ardian, ku ishit në momentin që banesa kishte marrë flakë?**

Në fshatin Daullas, po takoja një shok. Ajo zonja bëri tentativë për ta djegur njëherë. E kisha nxjerrë përjashta, nuk e di ku vajti e po kthehej. Aty tek kthesa e pashë dhe i thashë që ik se është shtëpia hapur.

ngjarjes si dhe tentativën e mbytjes së vajzave të saj, të cilat i kishte nga një martesë më e hershme. Me Ardian Gjiken kishin pak ditë që ishin ribashkuar pas një zënke të mëparshme. Mësohet se Rudina Kishta ka shfaqur shenja paqëndrueshmërie mendore dhe për këtë arsye hetuesit e çështjes kanë kërkuar ekzaminim mjekësor të saj. Ndërkra, dy vajzat e saj janë marrë në mbrojtje dhe janë transferuar në një institucion kujdesi në kryeqytet.



Ardian Gjika duke folur për 'GSH'

Sa mora kafënë, më thanë shokët shiko se po të digjet shtëpia. E mora për shaka, kur shikoj unë, shtëpia e djegur. **Di gjë se pse ia ka vënë flakën shtëpisë tuaj?** Bën vaki do ketë qenë me

depresion, kushedi. Se ajo më tha mua dua të iki tek nëna. Mbrëmë erdhi, pruri gjithë atë placë, një kamion. I thashë mbaro punët se do të të çoj në darkë. Ajo i ka vënë flakën. **Ju e kishit marrë këto**

ditë gruan në banesë? Dje (të hënën) sa e mora në shtëpi. Kishte dy fëmijë të vegjël, nga 6 vjeç. **Ku ishin fëmijët?** Me të ishin rrugës. **Ishte në banesë me zonjën?**

Nga mbrëmë? Jo sot? Nuk e di se isha në Daullas.

Pse mendoni se ia ka vënë flakën? Dontë të ikte tek mama. Jo, jo. E pata 6 muaj më para, iku ndenji pak, më tha mua do vij. **Çfarë ju është dëmtuar në banesë?**

Tej e tej, ç'kisha, i gjithë malli. Me divan e me të gjitha. **Bashkëshortja si quhej?** Rudina. Ia harrova mbiemrin...



I gjenden armë dhe kanabis, bie në pranga 25-vjeçari

VLORE - Policia e Vlorës ka arrestuar një 25-vjeçar, i cili akuzohet për veprat penale: "Kontrabanda me mallra të tjera", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe i municionit", "Prodhimi, shitja e narkotikëve" dhe "Kultivimi narkotikëve". Bëhet fjalë për Denis Muhametaj, banues në fshatin Llakatund, i cili u vu në pranga gjatë operacionit të koduar "Mercury". Mësohet se gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale: 1 armë zjarri automatische model 56; 4 kërehëra pistolete dhe kallashnikovi; 1260 copë fishekë pistolete dhe kallashnikovi; 3 motorë për mjete ujore me 300 kw fuqi; 3 automjete tip furgon, autoveturë dhe kamioncinë; 15,7 kg kanabis dhe 340 kubikë kanabis. Materialet hetimore në ngarkim të tij iu referuan për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pritet që gjykata e qytetit bregdetar të vendosë masën e sigurisë ndaj 46-vjeçarit Muhametaj.

U mbyt në ujërat e lumit Mat, gjendet pas disa orë kërkimesh trupi i 46-vjeçarit

MAT - Një 46-vjeçar ka humbur jetën mesditën e djeshme në lumin Mat. Mësohet se ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:30 në vendin e quajtur "Ura e Shkopetit". Ndërsa, viktima është identifikuar si Arben Marku nga fshati

Skuraj i Milotit. Burime policore bënë me dije se Marku është futur në ujë për t'u larë, por është mbytur pasi e ka marrë rrjedha e ujit. 46-vjeçari është gjetur disa orë pas ngjarjes disa metra larg nga vendi ku ai u mbyt. "Nga këqyr-

ja paraprake, nuk janë konstatuar shenja dhune apo të ndonjë dukurie fizike në trupin e tij. Vazhdojnë hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Table with multiple columns listing names and locations. Includes entries like ROLAND FEJZI LIKJA, GJELSHO LULASH LAMTHI, and many others. Some entries have additional location codes like DELIU, JATA, KOPANI, etc.

Shëndetësi

Gjendra e tiroides ndodhet në pjesën e përparme të gushës, poshtë laringut, dhe në përgjithësi pesha varion nga 15-22 gram. Roli i saj në organizëm është tejet i rëndësishëm e kjo nis që në fillimin e embrionit pra, nëse tiroidja është në normë edhe truri në fetus zhvillohet normalisht, e po ashtu edhe dhëmbët, flokët, organet. Kjo gjëndër kaq e vogël ka si aktivitet primar prodhimin e dy hormoneve që janë tiroksina dhe trijodotiroksina.



Mjeku popullor: Gratë 4 herë më të rriskuara se meshkujt, shkak menopauza

Voltiza Duro

Gjendra e tiroides ka një rol të rëndësishëm në organizmin e njeriut pasi është përgjegjëse në prodhimin e dy hormoneve: tiroksina dhe trijodotiroksina. Por jo në pak raste, sasia e jodit nuk qëndron brenda parametrave normalë, e kjo sjell probleme të shumta në shëndetin e njeriut. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", mjeku popullor Ylli Merja tregon se femrat janë 4 herë më të predispozura sesa meshkujt për t'u prekur nga sëmundjet që lidhen me gjendrën tiroide. Më tej mjeku shpjegon të gjitha simptomat që nuk duhen neglizhuar nga të sëmurët e, gjithashtu, tregon recetat më të mira të mjekësisë alternative për kurimin e rikthimin në gjendjen normale të tiroides.

Cili është funksioni i gjendrës tiroide në organizmin e njeriut?

Gjendra e tiroides ndodhet në pjesën e përparme të gushës, poshtë laringut, dhe në përgjithësi pesha varion nga 15-22 gram. Roli i saj në organizëm është tejet i rëndësishëm e kjo nis që në fillimin e embrionit; pra, nëse tiroidja është në normë edhe truri në fetus zhvillohet normalisht, e po ashtu edhe dhëmbët, flokët, organet. Kjo gjëndër kaq e vogël ka si aktivitet primar prodhimin e dy hormoneve që janë tiroksina dhe trijodotiroksina. Tiroksina ka si funksion që gjatë prodhimit nga tiroidja një pjesë të shokëve të akumulohet në mëlcë dhe pjesa tjetër të komandojë hipofizën në mënyrë që kur bie niveli i TSH-ashit në gjak, të nxitet prodhimi i tij. Ndërsa trijodotiroksina komandon aktivitetin fiziologjik të organizmit, pra është një jod, i cili merr pjesë në prodhimin e enzimave dhe i stimulon ato për punë, kur është në parametra normale.

Cfarë ndodh kur jodi nuk është brenda parametrave normalë?

Ka raste kur ky jod nuk është brenda normave normale e si pasojë fillon të

YLLI MERJA: Problemet me tiroiden, receta për kurimin e sëmundjes

"Si të përgatishni mjaltin me arra"



Mjeku popullor Ylli Merja

"çalojë" organizmi. Po përmend dy sëmundje patologjike të para që tregojnë se gjendra tiroide nuk funksionon normalisht. Mungesa e hormonit të tiroides është një nga shenjat e para, e cila njihet si hipotiroidizëm dhe shoqërohet me këputje trupore, dëshirë për të fjetur, tharje e lëkurës, rënie flokësh (nëse shihet në analizë, rrënja e qimes rezulton e rrudhosur, e këputur). Gjithashtu, hipotiroidizmi shoqërohet

edhe me uljen e pulsit të zemrës dhe shenja nervozizmi që shfaqet pa shkak, shpesh, por që zgjat pak kohë. Në rastet kur individ ka këto shenja klinike, zgjidhja më e mirë është që të bëjë një

vizitë te mjeku, të realizojë një eko të tiroideve si dhe kryhet një analizë për të parë nivelin e jodit në gjak.

Cilat janë kategoritë më të predispozura nga sëmundja?

Tiroidja përpunon jodit që e merr organizmi nëpërmjet ujit apo produkteve të ndryshme ushqimore. Në të dyja format e marrjes së jodit, bëhet ky përpunim dhe enzimat fillojnë të stimulohen. Moshat më të prekura nga çrregullimet e gjendrës tiroide janë ato mbi 50-të vjeç ndërsa vlen të theksohet se femrat janë 4 herë më të rriskuara sesa meshkujt. Kjo pasi ajo fillon që të futet në periudhën e menopauzës dhe ka një rënie të përgjithshme të gjendrave endokrine të saj siç është edhe gjendja e tiroides. Ndërsa në rastin e hipertiroidizmit kur këto tiroide janë më shumë të stimuluar do të dallohen të kundërtat e shenjave të para si: individit flet shpejt, është shumë aktiv, i papërmbytur. Edhe në këto raste pacienti duhet të kryejë patjetër ekzaminimin e tiroideve. Në të vërtetë njerëzit nuk e mendojnë që ky çrregullim kaq i vogël, në minitaturë i tiroides sjell këto pasojë kaq të mëdha. Të sëmurët mund të kryejnë lloj-lloj analizash të tjera, por shkak i vërtetë qëndron diku tjetër.

Si bëhet kurimi me bimë medicinale i gjendrës tiroide?

Në varësi nga stadi i sëmundjes, përdorim bimë efikase, stimuluese për të rikthyer funksionimin normal të saj. Nëse do iu referohemi zonave malore (është tipike mungesa e jodit në organizëm) atëherë do të rikujtojmë arrën. Kjo e fundit ka jod, sidomos kur është në fazat e para të rritjes, përqindja e jodit shkon deri në 60% të frutës dhe 30% e

vitaminës C. Me zmadhimin e frutës, bie përqindja e jodit e rritet përqindja e vitaminës C. Nëse vjelim pak nga kokrrat e arrës, i shpojme dhe i konservojmë në mjaltë, pasi t'i konsumojmë do të vëmë re efektet e mrekullueshme në rregullimin e funksionit të gjendrës tiroide. Mund të përdoret një gjysmë kokërr në javë, pasi e keni lënë 30 ditë në mjaltë, e kjo është më se e mjaftueshme për t'i siguruar organizmit sasinë e jodit të munguar. Ndërkohë edhe petat e arrës janë të pasura me jod e tanine, dhe ndikojnë edhe në sistemin nervor por edhe ndihmon në absorbimin e jodit nga trupi.

A ka ndonjë kurë shoqëruese që ndihmon në trajtimin më të shpejtë të sëmundjes?

Nëse konsumojmë 2 lugë çaj në ditë vaj kokosi, atëherë do të rregullohet mirë funksionimi i tiroides, por do të frenojë rënien e flokëve. Edhe likopsi është i mrekullueshëm për të gjithë ata persona që kanë tepri të jodit në gjak pasi është e vetmja bimë që garanton largimin e jodit të tepërt nga organizmi, qetësimin e sistemit nervor si dhe balancën ngacimim e gjendrave për prodhimin e hormoneve të tiroides. Ndërkohë gjembi i gomarit rregullon e përmirëson funksionin e mëlcisë, çka ndikon në qetësimin e gjendrave me sekrecion të brendshëm. Por edhe çaji i gjelbër e bajamet e egra kanë efekte të shpejta në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të personave që vuajnë nga tiroidja.



STRESI ËSHTË SHKAKTAR I PROBLEMEVE ME DHËMBËT

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E enjte 16 Gusht 2018



Olta Gixhari pozon me bikini, kështu nuk e keni parë kurrë



Oriola Marashi del topless para pasqyrës

BULEVARDI POLITIK



- E pabesueshme! Harta e Kosovës shfaqet në qiell, Nishani ka një mesazh
- Kryeministri Rama uron Ditën e Shën Mërisë, ja çfarë ka zgjedhur
- Sportiv dhe me pantallona të shkurtra, Ditmir Bushati përkrah djalit
- Berisha publikon videon: Linda Rama me çarter privat



• Rrëfehët modelja: Modelingun profesion i bukur për jashtë, surprizat në shtator

ATALANTA KËRÇYKU:

Kam ide programative që nuk janë bërë ndonjëherë në Shqipëri

"Lërinë njerëzit të bëjnë ç'të duan me jetën e tyre"

Rrëfëhet modelja: Modelingu profesion i bukur për jashtë, surprizat në shtator

Atalanta Kërçyku:

Kam ide programative që nuk janë bërë ndonjëherë në Shqipëri

"Lërinin njerëzit të bëjnë ç'të duan me jetën e tyre"



Egla Xhemali

Modelingu sipas saj është profesion mjaft i bukur, por që ka perspektivë më shumë për jashtë. Në vendin tonë mungojnë njerëzit që duhet ta vlerësojnë ashtu siç duhet punën e modeleve. Atalanta Kërçyku ndan me ne në "Summer Pages" të fshehtat e kësaj bote mrekullish. Bukuroshja thotë se bukuria është një çelës për t'i hyrë televizionit dhe në të shumtën e rasteve vërtetohet se ajo mjafton për t'u bërë pjesë e tregut mediatic. Atalanta që ka rrëmbyer çmimin "Miss Ballkani" dhe që ka marrë pjesë në pasarela të rëndësishme në vende të ndryshme na tregon se këto kanë qenë momentet më të lumtura për të. Ajo është shumë e ëmbël dhe me të qeshur na pohon se, nëse do kishte një koktejl që do mbante emrin e saj, padiskutim që do ishte një miksi frutash. Modelja mërçizet vetëm atëherë kur njerëzit ndërhyjnë në jetë e të tjerëve. Më shumë se sa pasarelat e mëdha, bukuroshja dëshiron "Photoshooting Model". Shtatori do sjell surpriza për Atalantën. Në i urojmë Kërçykut suksese dhe arritje sa më të mëdha!



Si të duken modelet?

Profesion i mrekullueshëm jashtë Shqipërisë. Në Shqipëri nuk ekziston asnjë modele që i përmbush të gjitha standardet e të quajturit e tillë. Të bësh disa foto të bukura në një agjenci të vogël përsëri s'të bën të tillë. Duhet të

prekësh pasarelat ose setet e mirëfillta të photoshootingut. Për të mos folur pastaj për modelet e "Instagramit". Çdo 3-4 vaxa janë të tilla... **Çfarë i mungon botës së modelingut sot?**

Në Shqipëri mungojnë investitor seriozë dhe njerëz, që duhet ta vlerësojnë me seriozitet këtë profesion. Nëse këto të dyja funksionojnë, gjithçka mund të ndryshojë këtu. Kështu mund të fillojë ekzistenca e modelingut shqiptar.

Natyrisht, kjo gjë bëhet kur kemi një shtet më të emancipuar. Momentalisht kemi ende probleme të tjera. **A mjafton vetëm bukuria për të qenë në Tv?** Tregu ka vërtetuar se mjafton. Pastaj shumica janë përmirësuar me kohë, pasi eksperiencia bën të vetën. Unë ende mendoj se një vajzë e bukur dhe e përgatitur mund të jetë një aset me shumë në TV tona. **Modelingu është më shumë pasion apo profesion?** Tek unë ka lindur si pasion, por duke parë gjendjen e mosekzistencën e tij në Shqipëri e lash të flinte atë pasion. M'u rrizgjua pastaj nga një kërkesë pune në një agjenci të huaj. Vazhdova për disa


vite dhe po të mos isha rikthyer do kishte kaluar në profesion të mirëfilltë. Natyrisht, që është profesion, pasi paguhesh për punën që bën. Por, siç thotë shprehja "Bëj një punë që të pëlqen dhe nuk do punosh kur- rë asnjë ditë në jetën tënde". Cili ka qenë ai moment që do e konsiderojë si më të bukurin përgjatë rrugëtimit si modele? Miss Ballkani! Hera e parë që një shqiptare konkurronte dhe fitoi kurorën e më të bukurës në Ballkan. Gjithashtu, nuk mbetet pas dhe pasarelat e "Next Top Model of The World" në Lebanon dhe "Supermodel International" në Kore.

Një koktejl që do mbante emrin tënd, çfarë shije do kishte?

Unë nuk e konsumoj alkoolin ndaj mendoj se do ishte një miksi frutash ekzotike. Të ëmbla dhe me një shije, që mbetet gjatë e të bën të rikthehesh. O zot çfarë komplimenti ndaj vetes. (qesh)

Aventura më e rrezikshme që ke kaluar në verë?

Nuk jam njeriu i aventurave të rrezikshme. Por, meqenëse po flasim për modelingun edhe këtë gjë po e fus tek aventurat teksa e mendoj. Lashë universitetin për të vazhduar profesionin jashtë Shqipërisë për një peri-



Oriola Marashi del topless para pasqyrës

Setet e saj fotografike janë nga më të lakuarit në media. Oriola Marashi gjithmonë kujdeset të zgjojë vëmendjen e të gjithëve me pozat e saj provokuese. Këtë herë pa reëpeta ajo duket më sensuale se kurrë. Fotot e ndara në "Instastory" e saj janë një marramendje për të gjithë ata që janë fansat të anetares së OTR. Kjo verë duket se është mjaft e nxehtë për të, pasi fotot provokuese nuk kanë munguar për asnjë ditë në rrjetet sociale.



Olta Gixhari pozon me bikini, kështu nuk e keni parë kurrë

Aktorja Olta Gixhari gjithmonë ka qenë një tundim për fansat e saj në rrjetet sociale. Biondia seksi numëron një numër të konsiderueshëm ndjekësish. Këtë verë ajo është shfaqur dhe më tërheqëse se ndonjëherë. Në foton e fundit postuar në "Instagram", Gixhari shfaqet me bikini dhe paksa mendueshëm. 'Vetëm kur jam këtu, unë nuk dua të jem asgjëkundi tjetër'-shkruan Olta krahe fotos së postuar. Mbi një barkë, sensuale dhe mendueshëm, Olta nuk mund të ishte më origjinale se kaq.



A ka Atalanta një pasarelë që e ka ëndërr ta arrijë? Dikur kisha atë të "Victoria Secrets", si çdo modele besoj. Por, më pas kuptova se nuk jam shumë e dhënë ndaj sfilatave. Kërkonin shumë punë e kohë t'ia dedikoje e të jetoje vetëm për atë punë. Ndërsa unë kisha ende pasione të tjera. Më tërheqin më shumë setet e fotove, pra "Photoshooting Model".

Ke menduar ndonjëherë që të heqësh dorë nga modelingu? Në Shqipëri jo. Kur

udhë tre vjeçare, më pas u ktheva për ta rimbyllur atë. Quhet aventura e rrezikshme kjo gjë?

Je mjaft solare. Çfarë e mërzit Atalantën?

Asgjë nuk më mërzit më shumë sesa njerëzit që ndërhyjnë në jetën e të tjerëve. Kjo botë ka vend për të gjithë dhe diversialiteti e bën më të bukur. Lërin njerëzit të bëjnë ç'të duan me jetën e tyre dhe shijoni tuajën.

Si do ishte përkufizimi yt për lumturinë?

Krijoni një paqe në vetvete dhe çdo gjë do bëhet më mirë. Shijoni çdo moment dhe mendoni pozitivisht. Pozitivitet dhe një zemër e mirë, që sheh të bukurën në çdo gjë. Mendoj se këto janë çelsat e lumturisë.

shoh se ende kemi modele që nuk janë të tilla, them me vete pse të heq dorë. Jashtë kam hequr dorë kur u riktheva pas tre vjetësh.

Ku do të të gjejë shtatori?

Një punë e re ende surprizë. Normalisht dhe arkitektura vazhdon me projekte private në interior dhe eksterior.

A ke projekte në tv?

Po kam dhe Tv mbetet një pasion imi i kahershëm. Madje kam ide programative që nuk janë bërë ndonjëherë në Shqipëri, si në terren dhe në studio.

Çfarë formati të shkon më tepër?

Studioja mbetet e preferuara ime dhe formatet argëtuese me lojëra mendoj se më përshtaten. Mbetem larg formateve intervistues rigoroz.

Nevina Shtylla ikën nga Tv Klani? Ja reagimi i moderatores

Largimet e moderatorëve nga njëri televizion në tjetrin janë bërë shumë të shpeshta këto kohë, teksa pritet që të fillojë sezoni i ri televiziv. Para pak kohësh u përfol se edhe moderatorja Nevina Shtylla, e cila drejton emisionin "Jo vetëm modë", nuk do të ishte më pjesë e emisionit, madje u spekuloi se do të largohej edhe nga Tv Klan. Mirëpo, Nevina është shprehur se do të vazhdojë të jetë pjesë e Tv Klan edhe në sezonin e ri. Ajo nuk ka sqaruar nëse do të vazhdojë të drejtojë emisionin "Jo vetëm modë", por ka shtuar se do të ketë gjëra të reja për të cilat nuk mund të fliste ende



KESHILLA

Nëse ekzistojnë predispozita për sëmundjen e mishit të dhëmbëve apo infeksionin e zgavrës së gojës, vështirësitë mund të përkeqësohen nëse çdo ditë përjetojnë situata stresuese.

Mbase tingëllon e pabe sueshme, aq më parë në kontekstin e listës gjithnjë e më të gjatë të sëmundjeve për të cilat shkaktar është stresi, por edhe shumë probleme stomatologjike të shkaktuara nga nervozizmi dhe stresi.

Ekzistojnë disa probleme më të shpeshta me dhëmbët, për të cilat rrallë mendohet që kanë lidhje me gjendjen psikike të pacientit dhe në të vërtetë kanë lidhje gjithsesi.

KËRCËLLITJA E DHËMBËVE

Më së shpeshti kërcëllitja ndodh pa vetëdije dhe gjatë gjumit. Nëse vëreni që dhëmbët gjithnjë e më shumë shkurtohen dhe bëhen "të tejdukshëm" në vende të caktuara, me siguri është e nevojshme goma apo folia me të cilat kërcëllitja do të pamundësohet.

KAFSHONI PJESEN E BRENDSHME TË FAQES

Për disa njerëz kjo shprehje është e zhvilluar si mënyrë për ballafaqim me stresin. Akupunktura apo hipnoza janë tretmanë, të cilët mund të përdoren për eliminimin dhe pengimin e kësaj shprehje.

GJAKRRJEDHJA E MISHIT TË DHËMBËVE

Kjo me siguri është shenjë e sëmundjes së mishit të dhëmbëve (gingivitis apo periodontoza), e cila është e shkaktuar apo e përkeqësuar nga stresi. Infeksione të shpeshta orale (afte dhe fistula). Stresi gjithashtu mund të jetë shkaktar, sepse ia pamundëson trupit që të luftojë kundër infeksioneve. Këtu mund të ndihmojnë antibiotikët dhe shërimi i hollësishtëm.

DHEMBJA NË NYJA TË NOFULLAVE

Në disa raste nevojitet tretmani i nofullës, sikur splinti special apo botoksi, në mënyrë që muskuli të lirohet.

PROBLEMI ME KANALET NË RRENJET E DHËMBËVE

Këtu stresi, gjithashtu, është shkaktar, sepse ky problem shfaqet shpesh te njerëzit, të cilët kërcëllin dhëmbët dhe të cilëve nervat e dhëmbëve u janë të ekspozuar. Pastrimi i kanaleve është i obligueshëm.

ERA E KEQE

Thartirat e stomakut mund të grumbullohen kur jeni vazhdimisht nën stres dhe çojnë deri te refluksi, i cili shkakton erën e keqe.



Stresi është shkaktar i problemeve me dhëmbët



E pabesueshme! Harta e Kosovës shfaqet në qiell, Nishani ka një mesazh

Ish-presidenti Bujar Nishani publikoi një foto mjaft të rrallë. Ndonëse mund të jetë montazh, Nishani e ka dhënë mesazhin e tij. Sipas ish-presidentit, edhe Zoti e ka shkruar me dorën e tij, ndërsa u kërkon autoriteteve në Kosovë ta respektojnë. Me këtë mesazh, Nishani i referohet çështjes së ndryshimit të kufijve. "Kjo pamje është mbi qiell të Kosovës. 'Edhe Zoti e shkroi me dorën të vet'. Respektojeni!", shkruan ish-presidenti, duke mos dhënë më shumë detaje mbi foton.



Kryeministri Rama uron Ditën e Shën Mërisë, ja çfarë ka zgjedhur

Kryeministri Rama uroi besimtarët e krishterë dje për Ditën e Shën Mërisë. Ai zgjodhi një video me pamjet e kishës 500-vjeçare të Fjetjes së Shën Mërisë në Kosinë të Përmetit. "Dhe me këto pamje të kishës 500-vjeçare të Fjetjes së Shën Mërisë në Kosinë të Përmetit, një prej 100 fshatrave dhe pjesë e Programit Rrugët e Besimit, ku ka përfunduar ndërhyrja e parë dhe e plotë restauruese pas 38 vjetësh lënie në harresë, ju uroj gëzuar Ditën e Shën Mërisë!", shprehet z.Rama.



BULEVARDI

Në merrni seriozisht! 😊

POLITIK



Sportiv dhe me pantallona të shkurtra, Ditmir Bushati përkrah djalit

I zhveshur" nga kostumi i kryediplomatit, Ditmir Bushati është shfaqur vetëm pak minuta më parë ndryshe nga ç'jemi mësuar ta shohim. Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme ka publikuar një foto, ku shfaqet përkrah djalit të tij të vogël. Në foto ministri duket i veshur sportiv dhe ndodhet në Lëpushë të Malësisë së Madhe. Duket se Bushati po shijon freskinë e maleve këto ditë të nxehta gushti.



Berisha publikon videon: Linda Rama me çarter privat

Ish-kryeministri Berisha publikoi dje një video dhe mesazhin e qytetarit dixhital, sipas të cilit në një çarter privat, në datën 9 korrik pretendohet se është Linda Rama, gruaja e kryeministrit edhe pse në video nuk duket në bëhet fjale vërtet për të. Pamje të qarte nuk ka dhe duket thjesht një zonjë teksa hipën në avion, pa elementë identifikues. "Edhe Madame Rama (Basha) udhëton me çarter privat! Lexoni mesazhin dhe shikoni videon e qytetarit dixhital. Së 'Mirëdita doktor, po të nis videon e fluturimit të Linda Ramës më datë 9 korrik nga Rinasi", shkruan Berisha në përshkrimin e videos.



GALERIA KOMBËTARE E ARTEVE

Ministria jep 12 milionë lekë për restaurim

Hapet tenderi, "e amortizuar dhe e degraduar"

Fatmira Nikolli

Muzeu Kombëtar përgatit për një periudhë rehabilitimi. Brenda vitit do kemi projektin e ri për të kaluar më tej në zbatim. Galeria Kombëtare e Arteve merr emrin e ri Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura. Ka një fond të jashtëzakonshëm të veprave qoftë të para 100 viteve, qoftë të realizimit socialist. Godina është të mjaft e amortizuar, kërkon riorganizim. Kemi projektin e radhës. Galeria Kombëtare ka statusin monument kulture dhe me ligj ajo nuk preket por rehabilitohet. Do të ketë një koncept të ri bashkëkohor dhe do të ketë teknologji moderne.

Ndërtuam 4 muze në mandatin e kaluar, besoj që të gjitha institucionet e mëdha kombëtare janë në listë sepse që kur janë ndërtuar nuk janë prekur". Pak javë më parë, ministrja Mirela Kumbaro do të shprehej se GKA-ja do i nënshtronte një ndërhyrjeje.

12 milionë e 500 mijë lekë të rinj është fondi limit që ka vënë në dispozicion Ministria e Kulturës për rehabilitimin e Galerisë Kombëtare të Arteve. Hapësirat e objektit që ka marrë emrin Muzeu i Arteve të Bukura pritet t'i nënshtronte restaurimit, rikonstruksionit dhe rehabilitimit ndërsa Ministria e Kulturës ka hapur tenderin për hartimin e projektit. Tenderi është hapur më 10 gusht dhe ofertat pritet deri më 20 gusht, sipas faqes së Agjencisë së Prokurimeve Publike. Ndërkaq, në relacionin mbi gjendjen ekzistuese të Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura tregohen arsyet pse duhet bërë kjo ndërhyrje, pasi bëhet me dije se gjendja e përgjithshme e objektit shfaqet e rënduar dhe e amortizuar në kohë. Gjatë viteve, në objekt është ndërhyrë pjesërisht në rifiniturë dhe në mirëmbajtje. Salla e ekspozitës e katit të tretë ka nevojë të rikonstruktohet në mënyrë të tillë që të jetë sa më funksionale dhe në kushte teknike sipas standardit. Ndriçimi natyral i katit të tretë nuk është realizuar në formën dhe materialin e duhur, duke u bërë shkak për tejçimin e temperaturave të jashtme, por edhe shirave.

Hidroizolimi i godinës është në gjendje të degraduar, në pjesën e bodrumit ka prezencë të lagështisë, në perimetrin e jashtëm si dhe në terracë. Hidroizolimi dhe termoizolimi i hapësirave të dritareve është në gjendje të degraduar. Ndriçimi natyral i katit të tretë nuk është realizuar në formën dhe materialin e duhur, duke u bërë shkak i transmetimit jo vetëm të temperaturave të jashtme, por edhe shirave. Era kryesore duhet spostuar për të kthyer në identitetin Galerinë Kombëtare të Arteve. Është e nevojshme rikonstruksioni i ambienteve të Fondit të veprave dhe skulpturave. Sistemi elektrik është i amortizuar, nuk përmbush normat e lejuara dhe ka nevojë për shtimin e kapacitetit. Sistemi i aspirim/kondicionimit nuk është funksional. Ka mundësi të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit, si një



kusht shumë i rëndësishëm për kategorinë e funksionit të godinës. Mungon edhe një sistem sigurie. Këto janë vetëm disa nga problemet që kërkojnë ndërhyrje sipas relacionit të specialistëve të Ministrisë së Kulturës.

Që prej vitit 2007 Galeria Kombëtare e Arteve gëzon statusin Monument Kulture i kategorisë së dytë. Gjithashtu, përfshihet brenda zonës së mbrojtur "Qendrës historike të aksit kryesor të qytetit

të Tiranës", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 2017.

GKA

Galeria Kombëtare e Arteve është një institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Kulturës. Ajo funksionon në mbështetje të Ligjit për Muzetë dhe Ligjit për Trashëgiminë Kulturorë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo funksionon në bazë të statusit të saj, i cili aprovohet


nga Ministria e Kulturës, si dhe nga rregullorja e saj e brendshme. Galeria Kombëtare e Arteve i ka fillimet e saj me përpjekjet e një grupi artistësh shqiptarë dhe të Komitetit të Arteve të vitit 1946. Pinakoteka ishte institucioni i parë i arteve figurative në Shqipëri. Pas një pune të mirëfilltë dhe përpjekjesh të shumta më 11 janar 1954 u hap zyrtarisht për publikun Galeria e Arteve në Tiranë. Në vitin 1956, si rrjedhojë e

pasurimit të fondit të veprave të artit, prej lulëzimit të krijimtarisë dhe blerjeve të kohës, galeria u zhvendos në një godinë më të përshtatshme, me tri kate në rrugën "Fortuzi" dhe me hapësira ekspozuese të shumta, si brenda ashtu edhe jashtë saj. Galeria funksionoi në dy drejtime kryesore, në atë të linjës së përhershme ekspozuese dhe në çeljen e ekspozitave të përkohshme të artisteve shqiptarë e të huaj. Vizionet e reja rreth zhvillimit dhe ekspozimit të arteve figurative si dhe blerjet rritën numrin e veprave të artit dhe sollën kërkesën për një ndërtesë më funksionale, e cila u inaugurua më 29 nëntor 1974, në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", ndërtesë ku ndodhet edhe sot. Ky është dhe momenti i riorganizimit dhe rikonstruksionit të parë, i cili konsistoi në ngritjen e një strukture administrative, që përbehej nga disa sektorë përkatës dhe në funksion të veprimtarive artistike.

Fondi i Galerisë së re, deri në këtë periudhë kishte 340 vepra dhe në arkivin e saj ishin regjistruar 240 autorë. Në vitin 2009 në Galerinë Kombëtare të Arteve u bënë ndërhyrje dhe investime të rëndësishme, të cilat konsistojnë në një rikonstruksion cilësor të hapësirave të brendshme dhe kthimit të tyre sa më pranë projektit origjinal të ndërtesës, si dhe konceptimit të një linje të re muzeale që i përgjigjet njohjes, edukimit dhe informimit artistik të publikut shqiptar dhe të huaj në nivele sa më të larta. Galeria Kombëtare e Arteve është institucion kombëtar, qendror, muzeor, studi-mor, shkencor, me qëllim të vetëm ruajtjen, prezantimin, promovimin e trashëgimisë kombëtare të shtetit shqiptar në fushën e arteve pamore. GKA ka mision grumbullimin, koleksionimin, konservimin, dokumentimin, studimin, restaurimin, ekspozimin dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, duke promovuar veprat më të mira të artit pamor shqiptar të traditës dhe atij bashkëkohor kombëtar e ndërkombëtar.

Të dhënat kryesore	
Objekti i tenderit :	Hartim projekti për objektin "Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve)"
Autoriteti kontraktues :	Ministria e Turizmit Kulture Rinise dhe Sporteve
Procedura :	Sherbim konsulence
Tipi i kontratës :	Sherbime
Numri i referencës :	REF-82549-08-09-2018
Numri i Njollimit :	CN/3477/00052018
Fondi limit :	12.500.000 00 Lekë
Data e publikimit :	10-08-2018 Ora : 12.05
Data e hapjes :	10-08-2018 Ora : 08.00

SHKRIMTARI



Fatos Kongoli

Fatos Kongoli:

Mendova Eutanazinë

Shkrimtari rrëfen jetën pas operacioneve në spital

Nga Beti Njuma

Nuk mbaj mend çfarë më preku më shumë kur hyra në dhomën e spitalit. Fakti që nuk e njoha, aq shumë që ligur e tretur, apo gjendja e pashpresë në të cilën e pashë. Atë pasditë të vonë fillim marsi, Fatos Kongoli dergjej në katin e parë të repartit të Kirurgjisë në QSUT, në gjendje kritike, pas dy operacioneve të vështira, që nuk dihej si do t'u shkonte filli.

Qe operuar fillimisht në 12 janar, dhe ndërhyrja e dytë, më 10 shkurt kish qenë rrënuese për trupin e tij të brishtë. Shkrimtari i dashur ishte diagnostikuar me kancer dhe drama e tij që konsumuar në heshtje me bashkëshorten Lilin, që s'i ndahej për asnjë çast, larg fëmijëve që jetojnë në Amerikë dhe vetëm me ndihmën e mjekëve e të personelit spitalor, që e kishin ndjekur me kujdes ditë pas dite.

Ndoshta askush nuk do ta kish marrë vesh që Fatos Kongoli ishte rëndë pas dy ndërhyrjeve kirurgjikale, i klasifikuar me diagnozën "Ca - rectum", sikur më 28 shkurt, në "Facebook", botuesi i tij Fatmir Toçi të mos kish postuar lajmin e rëndë: "Fatos Kongoli ndodhet në periudhën postoperatore në QSUT 'Nënë Tereza' dhe ka nevojë për dhurim gjaku..."

Nuk e mendova dy herë. Edhe unë si shumë miq të tjerë rrenda në spital për të dhuruar gjak ndërsa në shtratin e dhomës së spitalit, (shefi i pavionit kish liruar enkas për shkrimtarin zyrën e tij) gjeta një njeri kockë e lëkurë, të verdhë, të harkuar mbi shtrat, me duart të përdredhura, me sytë e trembur e pa shkëlqim që përhumbehin diku dhe fytyrën e ngrirë, pa atë buzëqeshjen miqësore që ia njihja mirë, pas shumë takimesh e intervistash që kemi realizuar së bashku.

Bashkë me Fatosin gjendej Lili, bashkëshortja, infermierja, shoja e netëve të gjata pa gjumë, e dhimbjeve para e pas operacionit, e tekave të kuptueshme për një të sëmurë të



atij stadi, që prej dy muajsh jetonte në pavion, duke u kotur sa në karige e sa tek këmbët e shtratit spitalor; shoqëruese e pandarë në të mirë e në të keq.

Në atë mbretëri dhimbjeje ku koha rrjedh duke pritur, ku nga të katërta anët kishte të sëmurë, shumë syresh edhe të pashpresë, Lili dhe Fatosi u gëzuan që pas tre muajsh dhoma u mbush jo vetëm me mjekë, por me fytyra të dashura miqsh që u shprehën mbështetje, iu gjenden pranë dhe u thanë një fjalë të mirë, atë që shkrimtari kish nevojë të dëgjonin: Do t'ia hedhë paq!

E lehtë të thuhej me fjalë! Aq më tepër kur në 'Ipad'-in që mbante në duar, në hapësirën Notes, pas operacionit të vështirë Lili kishte shënuar: Një tmerri i vërtetë! Qoftë me kaq! Kanë kaluar thuasj pesë muaj, dhe tek më tregon shënimin e bërë ato ditë të vështira buzë vdekjes së të shoqit, Lulu, emri me të cilin Fatosi e thërrret me përkëdhelje, i kthen sytë drejt tij, i shtrëngon duart dhe nis të përkrahë edhe një herë shigjetat e atij udhëtimit të dhimbshëm, ku burrë e grua u besuan njëri-ri me të bardha. Fatosi e dorëzoi veten pa rezervë, pa kushte, por tek e fundit a kishte zgjidhje tjetër?

Çiftin Kongoli e takoj në Qerret, në një vilë të bukur buzë detit ku janë zhvendosur që prej fundmartit, pas daljes nga spitali. Miku Julien Roch, të cilit i janë pafundësisht mirënjohës u ka vënë në dispozicion shtëpinë e tij dhe gjithcka nevojitet për aftësimin e plotë të shkrimtarit.

Është pasditë herët dhe tekta pres hapjen e një porte të madhe hekuri afshi i nxehtë i gushtit më përvëlton dhe habitem sesi rrëzë pishave të larta nuk depërton asnjë grimë nga ajri i freskët i detit, pak metra më tej. Pas portës gri shfaqet Fatosi dhe e shoqja. Jemi të gëzuar që shohim njëri-tjetrin. Jam e lumtur që Fatosin e gjej përsëri në këmbë. Çapitet me kujdes e po ashtu ngadalë ngjitet shkallët që të shpjen në një holl gjigant me një mori librash në guhë të huaj, e ku mbi një piano gjenden edhe pesë tituj në shqip nga krijimtaria e tij. Ulemi dhe jam e paduruar të dëgjoj si ka ndodhur mrekullia, si u ngrit në këmbë përsëri tekta kujtimi i fundit që ruaja ishte ai i një burri në limb.

Me zërin e shtruar e duke mbajtur gjallë bisedën Fatosi nis të rrëfëjë kalvarin e sëmundjes, neglizhencën e tepruar që e çoi buzë vdekjes, analizat e njëpasnjëshme, ndërhyrjet, punën e shkëlqyer të dy mjekëve Prof Edmond Çelikut dhe Henri Kolanit dhe tërë ekipit mjekësor pa haruar qindra mesazhe nga miq e dashamirës, edhe të panjohur: "Erdhën njerëz që s'i njihja, lexues që nuk i mbaj mend" thotë Fatosi tekta kujton se ndodhi pikërisht ajo që s'donte, zhurma mediatiqe.

Operacioni i dytë ishte fatal. Humbja në peshë e shoqëruar me degradimin fizik i pamundësoi jo vetëm ecjen por edhe ndjeshmërinë në pjesët dërrmuese të trupit. "Isha një gjysmë i vdekur" rrëfen shkrimtari për çastet e pezullta mes jetës dhe vdekjes. Ndonëse ka kujtime të mjeçullta të periudhës së kaluar në reanimacion një gjë mban mend mirë gatishmërinë dhe mirësinë e personelit spitalor që i jepte kurajë.

Pastaj lëshon fjalinë që të mbledh një lëshim në grykë: "Mendova eutanazinë! Kur mësova hollësitë e post-operacionit, thashë, e ç'më duhet jeta?! Lute-sha që të ikja". Kërkonte një ikje dinjitoze, ashtu siç mund të kenë bërë edhe njerëz të tjerë të letrave. Si mund të harrohet rasti i shkrimtarit belg Hugo Claus, disa herë kandidat për Nobel në

letërsi, i cili në mars të 2008-ës, në moshën 78-vjeçare pas një kalvari të gjatë me Alzheimer, vendosi t'i japë fund jetës me eutanazi. Që sëmundja të mos e bënte të huaj ndaj vetes dhe të tjerëve shkrimtari i njohur zgjodhi "vdekjen e ëmbël" në një klinikë të Anversës në Belgjikë, një nga tri shtetet europiane bashkë me Luksemburgun dhe Holandën ku lejohet eutanazia.

Për fat, ky nuk ishte rasti për shkrimtarin shqiptar. Sot kur flet për eutanazinë Kongoli qesh me këtë mendim të çasteve të thella të dëshpërimit. Por kush ka jetuar aq gjatë në spital dhe pa shpresë e di se aty jeta ndalet, pëson një frenim dhe koha është e ndryshme. Një botë thuasj paralele, një dimension tjetër.

E tillë është edhe jeta e re pas spitalit, periudha e rehabilitimit dhe e riaftësimit fizik. Tashmë prej pesë muajsh, bashkë me çiftin Kongoli në vilën e Qerretit jeton edhe fizioterapisti i tij, Ermal Hylviu. "Nëse jetën ma shpëtuan kirurgët Çeliku dhe Kolanit, Ermali më ka ngritur në këmbë", thotë Fatosi, pa haruar sigurisht heroinën e vërtetë të çdo çastit, Lilin.

Që prej 21 marsit, dita e daljes nga spitali, dy herë në ditë shkrimtari i është nënshtruar një programi të specializuar rehabilitimi për të vënë përsëri në punë muskujt e duarve e këmbëve. Një proces i gjatë përballjeje me jetën e re, ku nuk ishte më zoti i vetvetes, por plot këmbëngulje titanike që me punë trupi të gjente mënyrën për të rifituar vetveten.

Një proces i gjatë për të mësuar teknikat për të kryer edhe lëvizjet më të parëndësishme, duke u stërmunduar shumë për të arritur një minimum pavarësie, deri sa dora-dorës u ngrit nga shtrati, arriti të çapitet, mbështetur pas parmakëve dhe Ermalit derisa u ngrit përsëri në këmbë. "Mësova nga e para të eci si një fëmijë, mësova të jetoj përsëri".

Në moshën 74-vjeçare, jeta e Fatos Kongolit, ndërjet prej shkrimtarëve më të dashur shqiptar ka ndryshuar. Në sirtarin e tij sot nuk ka më vetëm iluzione, personazhe për të cilave të zbrëthejë vetveten, por ka shpresë dhe një dëshirë të madhe për të jetuar. S'më mbetet veçse ta uroja: Mirë se erdhe përsëri mes nesh!

(Konika.al)

Opinion i Ditës

Krimineli - pjellë e çmendurisë kolektive


Nga Mimoza Hysa

(vijon nga faqja 1)

...përhershme, duke i bishnuar fajit e duke e kërkuar atë përtej vetes. Gjetja më e thjeshtë është ta kthejmë kriminelin në të sëmurë. Kjo mënyrë kategorizimi na çliron nga përgjegjësitë dhe na e bën të arsyeshme një ngjarje përtej çdo arsyeje. Nuk është i pari rast dhe nuk do të jetë i fundit: kjo jo sepse "kështu ndodh në gjithë botën", që është sërish një shprehje parashutë, e cila na nxjerr nga situata, duke harruar se shifrat e krimeve për frymë janë dëshmuese të një shoqërie që nuk po mëson të piqet dhe të nxjerrë mësim nga historia e saj. Ka të tjerë tregues kjo ngjarje, që dëshmojnë për thelbin që përipiqemi ta shmangim: si ka mundësi që një gjysh, që e ka rritur atë fëmijë, të shfaqet natyrshëm para kamerave dhe të mos arrijë të kuptojë përgjegjësinë e thellë të familjes në këtë krim? Si ka mundësi, që banorët përqark flasin për një familje të nderuar dhe një djalë që papritur i çudit me gjestin e tij?

Përgjigja e shkurtër do të ishte: sepse një shoqëri e sëmurë nuk e dallon dot të sëmurin që ka para syve, sepse ai përsërit po të njëjtat veprime si të gjithë, bën të njëjtën jetë si të gjithë dhe reagon pak a shumë si të gjithë. Prandaj, jeta e tij nuk na çudit, sepse ai është njëri nga ne, një kriminel potencial i rritur në një shoqëri me probleme të rënda, që kthehet në "kriminel" vetëm kur bën aktin final, zbraz armën. Por, a arrihet deri të zbrazja e armës?

Nëse do të donim të njihnim shkaqet e kësaj ngjarjeje, mund të provonim një pyetësor, në dukje të pafajshëm, për vrasësit mendjetohtë. T'i pyesim në dy nivele: si e ndërtojnë jetën e përditshme dhe si kujdesen për jetën shpirtërore. Pra, konkretisht, çfarë bëjnë sa hapin sytë? Me siguri shumica prej tyre do të thonë se shkojnë të pinë kafënë me kaçurrel në një gotë raki në klubin e fshatit. Në qofshin më të pasur e me prindër më zullumqarë, e pinë në bllok të shoqëruar me një pije më të shtrënjtë se rakia e rrrushit. Po t'i pyesim se si e nxjerrin bukën e gojës, një pjesë e mirë do t'ia vënë fajin qeverisë, edhe pse vetë nuk e kanë marrë mundimin ta kalojnë klasën e katërt e të mësojnë të punojnë bahçen para shtëpisë, ose, nëse i kanë paratë me shumicë, do t'ju shesin mend se si bëhet para ma duke shitur motrën, komshien, gruan apo duke shitur drogë. Po t'i pyesim se si e mbyllin degjojnë, do të rreshtonin zhurmë Noizi, Stresi apo Kallashi. Po t'i pyesim se çfarë emisionesh shikojnë, do të përmendin të gjitha butatat e galataxinjve të ekraneve, që kanë ditur të përqeshin veten, pa ditur të stigmatizojnë e të turpërojnë



veset e qelbura të kësaj shoqërie. Po t'i pyesim nëse kanë lexuar ndonjë rresht, do ta kuptojmë se kanë qenë potencial i gatshëm krimi i përgatitur nga vetë shoqëria jonë, që pasi i prodhon, i zbraz jashtë si jashtëqitje, duke dashur të pastrohet. Thirrja e hapjes dhe mbushjes së çmendinave nuk na shpëton: ne vetë kemi kontribuar për të ngritur një Çmendinë gjigante. Kur Franco Basaglia, psikiatri italian, ia doli më 1978-ën të fitonte luftën për të miratuar ligjin e mbylljes së çmendinave, kishte në mendje ndërmarrjen e një hapi revolucionar të trajtimit të çmendurisë si një sëmundje që shërohet përmes komunikimit dhe jo përmes izolimit. Po kjo nënkuptonte një angazhim të madh shoqëror, jo një lënë në gjendje të lirë, duke e kthyer në barut mendjet e sëmurë. Për Basaglia-n, mbyllja e çmendinave ishte vetëm hapi i parë që shënjonte fillimin e një këndvështrimi të ri ndaj shëndetit mendor, si një çështje të cilën shoqëria nuk mund ta shmangë me eliminimin

dhe mbylljen, por duhet ta përballë me një angazhim total. Por, edhe pse revolucionar si hap, në një shoqëri si e jona mbetet utopi, sepse kërkun nga shoqëria pikërisht atë që i mungon: ndërgjegjësimin për detyrën.

E vetmja fushatë ndërgjegjësuese që pati efekt në shoqërinë amerikane ka qenë ajo kundër duhanit, gjë që bëri që duhanpirësit të shihen ende sot e kësaj dite në atë vend jo vetëm si dëmtoes të vetvetes, por edhe si ndotës të ambientit e për më tepër të stigmatizohen për vesin e tyre. A nuk duhet ta kishte bërë me kohë një gjë të tillë edhe shoqëria jonë me pijanecët, kur rezulton se pas shumicës së krimeve në familje fshihet alkooli? A nuk duhet ta kishte etiketuar pijanecin si një figurë dështake, që prodhon dhunë, krim dhe degjenerim? A nuk do të kishte qenë e udhës që shoqëria dhe shteti të kishin marrë masa serioze për një dukuri të tillë, kaq karakteristike për Shqipërinë? Si ka mundësi, që kudo të shitet alkooli mund ta shmangë me eliminimin

porositet pa problem nëpër lokale, pa u kërkuar kartë identiteti, të mbyllën sytë kur gjimnazistët dehen paq netëve nëpër klube nate? Si ka mundësi, që një shoqëri që ka mbushur rrugët e botës me prostituta, nuk stigmatizon kofshët e gjoksit jashtë të gjimnazistëve në ambientet e shkollës dhe vend e pa vend në ekranet televizive? Çdo qeveri ka për detyrë të studiojë veçantitë e vendit dhe shoqërisë së saj, duke marrë masa konkrete në përgjigje të plagëve konkrete. Nëse lojërat e fatit apo klubet e lotove janë një çerdhe dembelizmi dhe lulëzimi veshesh, atëherë është detyra e shtetit të ndërhyjë me dorë të fuqishme. Por, natyrisht, kjo është si të heqësh pjesën e kalbur e jo të shërosh burimin e kalbëzimit.

Ajo çka përbën burimin është gjithnjë e më e vështirë për t'u identuar e gjithnjë më e pamundur të eliminohet. Edhe pse ne tashmë nga një shoqëri e kontrolluar me darë të hekurt, kemi kaluar në lirinë pa kufi e të keqinterpretuar, pa kaluar fazën kryesore, atë të

ndërgjegjësimi dhe të civilizimit. Kemi keqkuptuar konceptimin e kufirit në emër të "emancipimit", fjala e përditshmërisë në fjalorin e rinisë së sotme, ku çdo gjë është e lejueshme. Kjo lëvizje është kuptuar kundër çdo institucioni dhe pengese që vë kufi: familja si burg, shkolla kazermë ushtarë, puna tjetërsim dhe ligji si dhunë nga e cila duhet të çlirohemi. Por, si ta kuptojnë të rinjtë kufirin mes lirisë seksuale dhe abuzimit seksual e prostitucionit, mes përmirësimit të imazhit nga të meta të lindura dhe transformimit tërësor të paraqitjes, deri në tjetërsim dhe sëmundje; kufirin mes njohjes dhe mbajtjes nën kontroll të gjendjes emocionale dhe abuzimit me droga gjithfarë për të arritur gjithnjë kulmin e energjisë dhe të lumturisë; kufirin mes të qenit i dobishëm dhe të qenit i njohur, pa dalluar në është për të mirë apo për të keq; kufirin mes lirisë për të plotësuar dëshirat e tua dhe përgjegjëshmërinë për të mos cenuar të drejtat e tjetrit?

Do të besoja se kemi filluar të kuptojmë, nëse do të kisha dëgjuar gjyshin e vrasësit që të merrte përgjegjësitë e të thoshte vetëm dy fjalë në ekran: kam dështuar me familjen time; të shikoja dy prindër që të kërkonin ndjesë për papërgjegjëshmërinë në rritjen e një krimineli, ose, së paku, nëse flasim për një të sëmurë mendor, të kishin kërkuar ndihmë. Është e vërtetë që kapacitetet mendore janë të ndryshme, por një familje, edhe pse nuk është e thënë të kultivojë mendimtarë dhe filozofë, e ka për detyrë të rritë qytetarë që respektojnë ligjin dhe detyrimet shoqërore. E kjo arrihet kur fëmijët rriten me dashurinë për të bukurën e për të mirën.

Nëse krimineli i drejtohet në rrjetet sociale kryeministrit të vendit, kjo nuk përbën asnjë çudi, përdërisa e kemi ngritur vetë një platformë të tillë komunikimi, ku siç thotë Umberto Eco, ia japim fjalën në kuvend edhe të paditurit, edhe të pakultivuarit, edhe budallait, që dikur ia qepnin gojën edhe të klubi i fshatit. Jemi vetë në ndërtuesit e një sistemi të tillë, pasojat e të cilit po vuajmë. Atë armë vrasësit ia fali politika e degjeneruar e gjithë këtyre viteve të tranzicionit, ia mbushi padija e bërë mullar, që prodhojnë institucionet tona shkollore dhe ia zbrazi keqëdukimi, apo më mirë mosëdukimi, indifferenca familjare. Ai djalë është pasqyra që na nxjerr zbuluar, që ne nuk mund ta thejgjë dhe ta zhdukim as duke e kategorizuar si të sëmurë, as duke e varur e as duke e kalbur në burg. Ai është pasqyra e jetesës që kemi ndërtuar, e cila nuk pasqyron vetëm atë që Niçja paralajmëroi një shekull më parë, rritimin e vlerave njerëzore, por edhe të një indiference absolute. Nëse përipiqemi që këto tri instanca të një shoqërie, si familja, shkolla, shteti, të mos i vëmë para përgjegjësisë e ta kategorizojmë edhe kësaj here thejsh si një vrasje të radhës së një të çmenduri, atëherë le të presim në heshtje edhe vdekjen tonë.

Opinion *i* Ditës

Lira turke dhe ekonomia jonë

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...me 40 përqind të vlerës së saj të këmbimit me dollarin amerikan, euron e me radhë. Shkak është përkeqësimi i marrëdhënieve të shtetit turk me partnerin e tij numër një në botë, ekonominë amerikane. SHBA-të janë eksportuesi më i madh në botë i çelikut dhe aluminit turk. Njoftimi të premtën 10 gusht nga ana e Presidentit amerikan Trump se kishte miratuar dyfishimin e tarifave mbi çelikun dhe aluminit turk, solli që vetëm në një ditë, të hënën më datë 13 gusht 2018, lira turke të bjerë më shumë se 11 përqind kundrejt dollarit. Vetëm javës së kaluar, kjo monedhë ra me më shumë se 20 përqind po ndaj dollarit. Rënia e lirës turke ka trazuar jo vetëm Azinë financiare ku Turqia është e pranishme me investimet e saj, por edhe tregjet evropiane të kapitalit, me aksionet e bankave kryesore evropiane që janë nën presion të veçantë për shkak të ekspozimit të huadhënësve të tyre ndaj Turqisë (sidomos bankat BBVA spanjolle, UniCredit italiane dhe BNP Paribas franceze). Shumë ekonomi të mëdha evropiane kanë interesa të larta investimesh në Turqi. Po ekonomia jonë? Turqia është partneri ynë i tretë tregtar, pas Italisë dhe Greqisë. Për fat, situata do të kishte qenë problematike tek ne, nëse do të kishte ndodhur dukuria e kundërt, forcimi i lirës. Kjo, për arsye se, sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT), ne jemi një vend që importojmë shumë nga Turqia. Kurse për të eksportuar (rasti kur mund të dëmtoheshim nga rënia e madhe e monedhës turke), eksportojmë shumë pak, vetëm 58 milionë dollarë për gjashtë muajt e parë të këtij viti (ose 0.6 përqind e totalit të eksporteve), kryesisht materiale ndërtimi dhe metale. Turqia zë vendin e tretë, pas Italisë dhe Greqisë, për importet tona (8 përqind të totalit të importeve). Importojmë tekstile dhe këpucë. Ai që ne në Tiranë i themi tregu çam, por edhe tregu tek Medreseja, kanë pikërisht dhe kryesisht mallra të lira turke. Këto tregje janë të përhapura në të gjitha qytetet tona. Importojmë shumë edhe produkte kimike dhe plastike nga Turqia. Rënia e lirës me 40 përqind këtë vit normalisht duhet të kishte ulur po kaq mallrat e tregut çam apo tregut tjetër. Kjo sigurisht nuk ka ndodhur dhe nuk do të ndodhë, për shkak të dukurisë "alla shqiptarçe" të mos ndryshimit të çmimit, sa herë ai ulet ose zhvlerësohet monedha me të cilën malli apo shërbimi vjen në Shqipëri. Kjo ka 28 vjet që po ndodh me naftën që importojmë (90 përqind të totalit që konsumohet tek ne) dhe me shumë produkte të tjera që sigurohen kryesisht nga importi. Është rrjepja po "alla shqiptarçe"



e konsumatorit tonë, që jemi të gjithë ne. Por të paktën mund të themi se kjo krizë turke në këtë fushë, nuk ka pasojë negative mbi ekonominë tonë. Investimet turke janë të rëndësishme, duke u jetësuar në telekomunikacion dhe në sistemin bankar të nivelit të dytë (bankat tregtare) tek ne. Edhe këtu nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, pse banka me kapital turk, Banka Kombëtare Tregtare (BKT) nuk ka ndonjë ekspozim (rrezik) ndaj letrave me vlerë, aksioneve në

ekonominë turke. Për vitin e kaluar, 2017-ën, investimet në monedhën turke, sipas bilancit zyrtar të BKT-së, përbënin vetëm 6.5 përqind të totalit të investimeve të bankës. Banka Kombëtare Tregtare ka pasur një aktivitet të qëndrueshëm në vite, me tregues të lartë të përfitueshmërisë dhe kthyeshmërisë nga aktiviteti dhe nga kapitali. Megjithatë, investimet turke në Shqipëri, për shkak të klimës dhe gjendjes së sotme të ekonomisë turke, nuk priten të sh-

tohen për vitet në vijim. Një partner i rëndësishëm tregtar i ynë, si Turqia, është në vështirësi. Nga kjo gjendje, qeveria jonë duhet të reagojë, duke patur një arsye më shumë për të sjellë në shtator një plan veprimi dhe qasje më agresive (në kuptimin më pozitiv të mundshëm) për përthithjen e investimeve të huaja, pasi kemi më shumë se 6 vjet në vend numëro me prurjen e ndonjë emri të rëndësishëm investues të huaj strategjik në tregun tonë.

HOROSKOPI

DASHI
Mos u bëni nervoz dhe mos humbni besimin tek vetja juaj, kur të takoheni me disa persona të profilit të lartë. Shmangni personat të cilët iu afrohen vetëm për interes. Ka gjasa që sot të fitoni rritje në detyrë. Sa i përket çifteve të martuar, do të përballen me disa probleme, por të dy bashkë do t'i kaloni me inteligjencë.

DEMI
Sot do t'ju vizitojë një mik i vjetër me të cilin do të kujtoni momentet më të bukura që keni kaluar bashkë. Bëni kujdes gjatë ditës, kur të shprehni idetë tuaja, pasi sikurse një lëvizje e gabuar do t'ju kushtojë.

BINJAKET
Përpikuni t'i zgjidhni problemet tuaja dhe mos t'i lini pezull ato. Kjo do të shmangë tensionin duke iu bërë të ndiheni i qetë. Nëse jeni prindër, sot do të zhgënjeheni nga fëmijët tuaj pasi nuk kanë dhënë rezultatin që ju prisnit.

GAFORJA
Sot ka gjasa që të bezdisin vëllain/motrën për shkak të ndërhyrjes në punët e saj/tij. Mos jepni këshilla kur nuk duhet, pasi nuk do të mirëprehen nga të tjerët. Do të keni dëshirë të udhëtoni dhe të shpenzoni para, por më pas do të pendoheni.

LUANI
Meditimi dhe joga do t'ju ndihmonin shumë në largimin e stresit. Jepni kohën e duhur familjes suaj. Bëjini të kuptojnë që ju kujdeseni për ta. Mos i dorëzoni disa dokumente të rëndësishme shefit tuaj, nëse nuk keni "kopsitur" gjithçka. Jeta martesore është bekim dhe ju do ta vërtetoni këtë sot.

VIRGJERESHA
Sot t'ju plotësohen disa prej dëshirave tuaja. Puna e lodhshme e disa ditëve të mëparshme do të sjellë rezultate. Familjarët do të mbështesin pikëpamjet tuaja. Përpikuni që në lidhje tuaj romantike të jeni sa më realistë. Ndëqni ndjenjat para se të veproni.

PESHORJA
Përpjekjet tuaja të mëdha dhe mbështetja familjare do t'ju sjellin rezultatin e dëshiruar. Megjithatë, vazhdoni të punoni fort që të jeni njësoj të kënaqur. Ka gjasa që sot të merrni vendime në momentin e fundit. Planet tuaja mund t'ju prishen për shkak të axhendës së ngarkuar në punë të partneres/partnerit tuaj.

AKREPI
Kushtojni më shumë vëmendje shëndetit tuaj dhe mos harroni të bëni ushtrime fizike. Kontrolloni tendencën për të shijuar momentin dhe mos shpenzoni shumë para për tu argëtuar. Shprehjani mirënjohjen të afërmeve, të cilët iu kanë ndihmuar në momente shumë të vështira.

SHIGJETARI
Sot nuk do të keni energjitë e duhura dhe do të irritoheni edhe për çështje shumë të vogla. Partneri/partnerja juaj do t'ju befasojë, pasi do të realizojë diçka, të cilën ju kishit kohë që e prisnit. Mos i lejoni të tjerët që të kuptojnë sesi ndiheni ju sot.

BRICJAPI
Do të ishte mirë të bënit një vizitë mjekësore për të kontrolluar disa probleme me shëndetin tuaj. Do t'ju vijë një dhuratë nga një i afërm juaj, gjë e cila do t'ju lumturtojë shumë. Sot do të kuptoni se dashuria mund të zëvendësojë gjithçka.

UJORI
Sot do t'ju duhet të merrni një vendim të rëndësishëm, çfarë do t'ju bëjë të ndiheni shumë nervoz. Është momenti i duhur për të kursyer para, përndryshe do të pendoheni në të ardhmen. Gjithçka sot në punë do të jetë në favorin tuaj. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat.

PESHQIA
Do të ndiheni të mbushur plot energji. Mos shpenzoni shumë para për t'iu rënë në sy të tjerëve. Përpikuni të kontrolloni veten, në mënyrë që të mos lëndoni njerëzit pranë jush. Bëni mirë të zgjidhni sot një konflikt të vjetër, pasi nesër mund të jetë vonë. Ka gjasa të përballeni me një debat të fortë me partneren/partnerin tuaj.

Lista e pestë me pronarët që do të kompensohen për tokat e sekuestrua në '45-ën

Ornela Manjani

Buxheti, 15 miliardë lekë për pronarët, 5 mijë përfitues në të gjithë vendin

ATP ka miratuar kompensimin për dosjet 2001-2014

Qeveria ka miratuar një fond prej 15 miliardë lekësh, të cilat do të shpërndahen për të paktën 5 mijë pronarë, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit të pronës dhe s'kanë marrë deri tani asnjë lekë. Fondi është i ndarë në tri vite 2019-2022, i cili rritet progresivisht vit pas viti. Në projektbuxhetin afatmesëm është miratuar fondi për vitin 2019 në vlerën 4.9 miliardë lekë, për vitin 2020 në vlerën 5.3 miliardë lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 5.4 miliardë lekë. Sipas ligjit në fuqi, pronarëve që u është njohur e drejta për kompensim do të marrin 20% të vlerës në lekë dhe pjesën tjetër 80% kompensim me

tokë. Ndërkohë pronarët mund të aplikojnë për të përfituar nga skema për pagesa të përshpejtuara.

TRI AFATET

Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqind-

ja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht ren-

dit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i


kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese që shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit finan-

ciar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

PËRFITUESIT NË TË GJITHË VENDIN

66	Shkodër Guljem Serreqi	2,025,000
67	Shkodër Guljem Gjon Serreqi	1,620,000
68	Shkodër Guljem Gjon Serreqi	1,737,477
69	Tiranë RAMAZAN SHABA	11,442,000
70	Tiranë MELEQE ILJAZ GJONI	11,186,000
71	Durrës Sali Kadrimi	1,879,787
72	Elbasan SKENDER KOSTURI	4,475,520
73	Korçë ANESTI MISTO CULE	225,000
74	Korçë Robert Papi	97,416
75	Gjirokastër Muharrem Kasemi	2,042,880
76	Gjirokastër Iliaz Koci	2,042,880
77	Shkodër Gjon Serreqi	12,150,000
78	Durrës Zeman Hoxha	9,250,000
79	Lezhë Hamdi Milka	
80	Berat Anila Doga	
81	Shkodër Guljem Serreqi	12,658,761
82	Durrës Xhumaje Guza	424,790
83	Durrës Hysen Ismail Shehu	20,008,500
84	Tiranë AHMET BRAHIMAJ	14,590,912
85	Tiranë HILDA BASHA (BENDO)	6,270,000
86	Tiranë ZHILA	283,477,768
87	Shkodër Daut Malevija	
88	Tiranë SERVETE KANAPARI	31,584,000
89	Vlorë Pjerita Çika	-83,070,970
90	Berat Mysret Jaupi	45,177,650
91	Berat Ruzhdi Orizaj	19,943,688
92	Berat Fatim Baballeku	29,580,000
93	Fier Fatmir Allmucca	
94	Berat Themistokli Bishka	30,936,000
95	Fier Skender Milori	1,888,740
96	Berat Çezar Koshi	
97	Kukës Hajredin Shaban Elezaj	
98	Tiranë AV DENIS SELIMI	42,190,470
99	Vlorë Adriana Simo	0
100	Vlorë Dhimitër Gjini	1,369,500
101	Berat Florian Sahatçi	7,105,000
102	Berat Lutfi Yzeiraj	
103	Berat Nikollaq Marini	22,164,600
104	Korçë Ali Hasan Zhabollari	14,444,400
105	Lezhë Rasim Selimi	
106	Tiranë GAZMEND DIBRA	716,800
107	Korçë Gjergji Jovan Koço	
108	Tiranë FLUTURA SKENDERI	2,893,061
109	Fier Jorgji Bare	0
110	Korçë Ervehe Bendo	1,700,000
111	Korçë	2,752,640
112	Shkodër Brigjida Shestani	
113	Vlorë Ymer Lluci	1,224,000
114	Lezhë Zef Përvizi	
115	Berat Emil Jaho	60,169,200
116	Korçë Yllka Xhumari	541,767
117	Shkodër Gjon Shuk Serreqi	5,081,400
118	Shkodër Guljem Serreqi	1,027,080
119	Gjirokastër Shefik Bushi	7,151,600
120	Korçë PETRINA PANARITI	239,000
121	Durrës Jakup Rama	
122	Korçë Pavlu Nace	3,948,400
123	Gjirokastër Arjan Sotiri	-1,267,019,670
124	Gjirokastër Gramoz Biliku	581,000
125	Vlorë Sedat Libohova	
126	Durrës Isa Bylykbashi	
127	Gjirokastër Simo Puci	-3,046,800
128	Korçë Muharrem Shehu	5,198,800
129	Vlorë Afrim Agalliu	0
130	Vlorë Afrim Agalliu	
131	Tiranë Monika Tahiri	67,674,313
132	Berat Dine Mulita	9,550,744
133	Vlorë Dashamir Xhaxhiu	134,520
134	Berat Andon Duka	15,823,444
135	Vlorë Gjinovefa Hoxha	-39,512,400
136	Vlorë Gjinovefa Hoxha	1,958,400
137	Tiranë AFERDITA XHEPA	23,744,000
138	Durrës Haxhi Bami	2,327,827
139	Durrës Haxhi Bami	2,327,827
140	Durrës Haxhi Bami	163,000
141	Korçë Haki Hajdar Caco	1,360,256
142	Shkodër Guljem Serreqi	752,907
143	Shkodër Gjon Shuk Serreqi	702,000
144	Shkodër Gjon Serreqi	3,723,165
145	Shkodër Gjon Serreqi	2,233,899
146	Tiranë TEQJA	0
147	Tiranë Skender Meta	1,111,572
148	Berat Sefedin Fuga	37,963,639
149	Tiranë KOLIQI	14,632,727
150	Tiranë KUME MECANI	13,393,800
151	Vlorë Gjinovefa Hoxha	979,200
152	Korçë Vasillaq Guri Lubonja	500,000
153	Korçë Enver Xhakolli	
154	Gjirokastër Gezim Gusmari	162,400
155	Dibër NIKOLLE LLESHI	
156	Gjirokastër Aliko Karagjizi	380,608
157	Korçë Edmond Liçi	-797,600
158	Korçë Athina Xhumentiku	1,200,000
159	Gjirokastër At Vasil Thomallari	
160	Gjirokastër At Vasil Thomollari	
161	Berat Thoma Kajana	4,080,000
162	Tiranë ALBI PETRELA	1,419,743
163	Vlorë Nexhip Xheneti	1,476,570
164	Tiranë Hilda Basha (Bendo)	11,200,000
165	Tiranë Hilda Basha (Bendo)	53,760,000
166	Korçë Athina Xhumentiku	2,500,000
167	Korçë Rita Engjellush Kuçana	
168	Korçë Gjylke Ibrahim Xhambazi	28,060,180
169	Shkodër Vassel Marku	-27,404,400
170	Korçë Dhimitraq Kristaq Aleko	500,000
171	Berat Baftjar Kafexhiu	3,075,450
172	Berat Nikolla Nosi	98,037,835
173	Berat Agif Hoxha	11,266,500
174	Korçë Jani Cekani	3,208,500
175	Shkodër Xhemal Çelepia	613,710
176	Tiranë QEFERE KERTESHI	42,112,000
177	Fier Hekuran Çepele	
178	Korçë Nefaret Llomi	2,604,000
179	Lezhë Pal Leka	
180	Tiranë HYSNELAJ	4,480,000
181	Lezhë Daver; Dritan Malci	3,051,200
182	Vlorë Harallamb Konomi	734,400
183	Berat Jani Papa	703,500
184	Berat Mihal Kurrizo	
185	Berat Roland Kolovani	9,235,929
186	Korçë Namik Zenel Hysenbegasi	10,949,643
187	Tiranë LYAN BARUSHI	19,712,000
188	Berat YMER TAFILAJ (TOFIL)	1,976,408
189	Tiranë Hilda Basha (Bendo)	35,840,000
190	Tiranë HILDA BENDO	8,960,000
191	Berat Arqile Shyti	2,943,500
192	Berat Miti Ndini Arapi	1,399,488
193	Berat Baftjar Kafexhiu	0
194	Durrës Abdulla Islam Keta	35,600,000
195	Tiranë FATIME RAMA	
196	Vlorë Kujtim Xhaxhi	0
197	Vlorë Anesti Rrista	489,600
198	Shkodër Gjon Serreqi	3,240,000
199	Berat Vangjel Veta	1,238,300
200	Kukës Gjyle Sadik Hila	
201	Korçë Gaqo Lola	1,131,400
202	Korçë Pellumb Haki Hadri	-440,240
203	Gjirokastër Leonard Papa	535,877
204	Tiranë HILDA BASHA	23,925,000
205	Korçë Kristaq Monçi Thana	935,000
206	Korçë Athina Xhumentiku	440,000
207	Korçë Elza Mertani	180,000
208	Tiranë Kujtim Haxhiu	
209	Tiranë Hilda Basha (Bendo)	7,347,200
210	Fier Ramadan Ago	40,231,640
211	Elbasan SKENDER BALLICI	
212	Korçë Jani Çekani	
213	Durrës Xhemile Haxholli	18,300,000
214	Durrës Bashkim Merkaj, Genciana Çurçiali	
215	Tiranë VERIANA HOXHA	
216	Fier Janaq Jorgo	40,838,000
217	Berat Vangjel Panajot Kumati	
218	Lezhë shaqe dema	10,001,050
219	Tiranë Zyhdi Gjuzi	-33,659,170
220	Durrës Xhemile Haxholli	0
221	Fier Muhamet Vrioni	
222	Fier Zelina Morina	1,210,500
223	Shkodër Guljem Serreqi	1,544,400
224	Durrës Adriatik Gjashta	3,573,000
225	Elbasan LUAN HOXHA	
226	Korçë Fredi Muci	132,000
227	Durrës Bajram Daci	4,956,500
228	Korçë PERTEF DEMIRALI DILKA	51,750,000
229	Dibër Selman Hysenagolli	
230	Tiranë QERIM SHIMA	
231	Vlorë Engjëllushe Dajko	-1,766,600
232	Durrës Gjystina Cela	16,862,000
233	Korçë Bashkim Myrteza	100,000
234	Korçë Silver Plasa	288,000
235	Korçë	2,475,000
236	Shkodër Xhemal Shaban Celepia	
237	Shkodër Ferdinand Topalli	
238	Tiranë OLSISHLJAKU	0
239	Korçë Bashkim Myrteza	1,898,500
240	Berat Mirjeta Katori	1,179,606
241	Shkodër Zhaneta Miloti	2,430,000
242	Korçë	84,300
243	Korçë Robert Mushka	
244	Korçë Oresti Gjeli Miço	5,445,700
245	Korçë Yllson Shefqet Haxhi	107,106,200
246	Korçë Marika Vangjel Roshanji (Kote)	
247	Korçë Ligor Vani Kalço, Thoma Vani Kalço	
248	Vlorë Refat Puto	-473,325,500
249	Vlorë Fejzi Kokalari	
250	Korçë GJERGJI BASHO	-328,095
251	Korçë KOZETA KEREKU	-3,161,134
252	Korçë Muhamet Sadik Neli	7,435,000
253	Korçë Erlejdin Balli	1,793,961
254	Durrës Bajram Daci	7,106,300
255	Korçë VALLE NACE	2,176,350
256	Tiranë PETRIT URUCI	0
257	Tiranë MERILA GJINALI	107,150,400
258	Korçë Refil Palla	5,440,000
259	Fier Arben Bejtja	
260	Tiranë MARIE KOSTANDINI	5,922,000
261	Tiranë MARIE KOSTANDINI	3,290,000
262	Tiranë MARIE KOSTANDINI	5,264,000
263	Tiranë QERIME BALLHYSA	
264	Tiranë NEPRAVISHTA	4,922,222
265	Tiranë Marie Athanas Kostandini	5,757,500
266	Berat Mustafa Qojle	2,358,500
267	Durrës Engjellushe Bylykbashi	8,475,000
268	Durrës Adriatik Kaja	340,500
269	Durrës Adriatik Kaja	
270	Korçë Astrit Myftari	6,323,574
271	Durrës Vasil Vava (Kasapi)	
272	Durrës Sabrije Farruku	4,049,400
273	Lezhë Prek Gjok Nika	
274	Tiranë ISMET GORANI	
275	Fier Mustafa Vokopola	
276	Korçë Alma Vafsi Iljaz	5,288,700
277	Tiranë ESAT DOLLA	8,883,000
278	Tiranë AV SHAQIR HASANAJ	79,626,141
279	Tiranë SELIM MALAJ	2,289,144
280	Lezhë Anton Marku	56,448,000
281	Korçë Arife Ali Bardhollari	20,791,125
282	Berat Gonilla Kreku	271,895
283	Lezhë Vitore Pjetrushli	15,545,250
284	Durrës Haxhi Bami	1,377,513
285	Fier Selim Bilali	
286	Fier Selim Bilali	
287	Durrës Beqir Ajazi	
288	Durrës Beqir Ajazi	469,734
289	Durrës Beqir Ajazi	10,485,000
290	Berat Fatmir Haxhaliu	146,160
291	Korçë Violeta Thoma Cika	850,000
292	Korçë Muharem Nedim Liban	22,141,200

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ishte dekret i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiqajti Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.

38. Sateliti i Jupiterit.
39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstremer në sirtar.
45. Kështu shtë lojtari i under 21.
47. Eshhtë gjuajtja personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuraturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendi.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisore.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishte gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihat kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorëzë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsja e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë skllavëri.
16. Eshhtë shtypi jo përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Etheh e tij zunë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

HORIZONTAL


33. Eshhtë trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshje.
39. Qetësonte detin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Eshhtë ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.

VERTIKAL


1. Gjysma e lapsit.
2. Përfundojnë pingul
3. Shkruhen për filma.
5. Duhet realizuar.
6. Gabim pa kufij.
7. Portokalli i Stanley Kubrick.
8. Në krye të artistëve.
9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shen Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turmin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



SUDOKU

		6	2			3		
	5			6	1			2
9		3			8	1		
			8		9			6
5		4	1					8
8	7	2						4
4	6	1		5				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	7	6	1	4	2	9	5	8
5	8	4	6	7	9	2	1	3
9	1	2	8	3	5	4	7	6
6	9	1	2	5	4	3	8	7
8	4	5	3	6	7	1	9	2
2	3	7	9	1	8	5	6	4
4	6	9	5	8	3	7	2	1
7	2	8	4	9	1	6	3	5
1	5	3	7	2	6	8	4	9

KRIPTOSKEME

8	4	1	2	3	4	6	5	3	4	1	4	
1	2	8	1	5		8	4	7	10	6	4	3
10	6	7		2	7		11	6	2	1	4	
10	7		15	1	12	1	2	3	4		10	1
1		12	1	4	3	2	6	4	3		1	2
4	2	6	11	3	2	6	4	3		1	14	3
1	2	4	16	2	7	16	6		18	1	4	2
1	2	8	3	14		3	1		1			
1	19	1		4		11	3	4	2	6		13
8	1	5	4		18	6	2	1	4	3	2	18p
5	16	1	10	6	4	3	4	6		3		18p
10	3		15	3	18	6			14	8	14	1A

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

M	I	K	E	K	M	S	E			
E	K	A	R	O	M	A	K	E	T	
K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	
P	A	S	A	N	I	K	T	S		
E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T
R	E	T	E	E	I	R	A	N	I	
I	T	R	B	L	A	K	E	L		
M	I	A	R	E	D	E	K	I		
E	M	E	T	A	L	E	I	S		
T	E	K	E	M	K	U	M	T		
M	O	R	A	V	I	A	M	A	E	

Argëtim filozofik

- Eshhtë gabim të lejosh që dita të gjykohej në mbrëmje, sepse atëherë, tepër shpesh lodhja bëhet gjykatëse e forcës, e suksesit dhe e vullnetit të mirë.
- Që të ndryshojmë botën, duhet të fillojmë me veten tonë... Eshhtë e rëndësishme të kuptojmë se kjo është përgjegjësia jonë, e juaja dhe e imja...
- Të filloni të shihni veten tuaj si shpirt me trup, dhe jo si trup me shpirt.

Thënie të mënçura

- - Dhjetë fukarenj flenë për bukuri në një qillim, ndërsa dy mbretër nuk i nxe një mbretëri.
- - Kërkush nuk di gjithçka, por është turp dhe e dëmshme të shtiresh se di atë që nuk e di.
- - Mos jepni këshilla pa ju pyetur.
- - Të mëdhenjt janë të mëdhenj vetëm sepse në jemi në gunjë.
- - Heshija dhe vetmia janë miqtë më të mirë të shpirtit.
- - Budallai kërkon se si të kapërcej vetminë, ndërsa i mënçuri gjen mënyrë për të shijuar atë.

